



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
KOMISIONERI PËR MBIKËQYRJEN E SHËRBIMIT CIVIL

RAPORT
(Përfundimtar)

PËR
INSPEKTIMIN NË LIDHJE ME ADMINISTRIMIN E SHËRBIMIT CIVIL

KËSHILLI I QARKUT TIRANË

Tiranë, Korrik 2015

RAPORT

Për kryerjen e inspektimit në lidhje me procesin e administrimit të shërbimit civil në institucionin, Këshilli i Qarkut Tiranë.

Hyrje

Komisioneri për Mbikëqyrjen e Shërbimit Civil ka rënë në dijeni të faktit se Këshilli i Qarkut Tiranë, me Vendimin nr.216, datë 22.12.2014, *“Për miratimin e strukturës organike të Administratës së Këshillit të Qarkut Tiranë”*, kishte kryer procesin e ristrukturimit të institucionit. Si rrjedhojë e pakësimit të ndjeshëm të fondeve financiare në buxhet, procesi i ristrukturimit ishte shoqëruar me reduktimin e numrit të punonjësve të Këshillit të Qarkut Tiranë, duke vendosur lirimin e disa prej tyre nga shërbimi civil. Duke e konsideruar të padrejtë aktin administrativ të lirimit nga shërbimi civil, me pretendimin se ka dalë nëkundërshtim me procedurën e parashikuar në nenin 50 e vijues të ligjit nr. 152/2013, *“Për nëpunësin civil”*, i ndryshuar, një prej ish-punonjësve të Këshillit të Qarkut Tiranë ka kërkuar verifikimin e rregullshmërisë së procesit të ristrukturimit nga Komisioneri për Mbikëqyrjen e Shërbimit Civil.

Për këto arsye, Komisioneri, në mbështetje të nenit 11 pika 1, si dhe të nenit 14, pikat 1 e 2 të ligjit nr. 152/2013, *“Për nëpunësin civil”*, i ndryshuar, me Vendimin nr. 31, datë 31.03.2015, *“Për kryerjen e inspektimit në lidhje me zbatimin e ligjit në administrimin e shërbimit civil si dhe në lidhje me procesin e ristrukturimit të institucionit, Këshilli i Qarkut Tiranë”*, vendosi kryerjen e inspektimit të përgjithshëm në këtë institucion në disa drejtime, si: lëvizja, transferimi apo lirimi nga shërbimi civil i punonjësve, nëse këto procedura janë bërë sipas parashikimeve të nenit 50 të ligjit nr. 152/2013, *“Për nëpunësin civil”*, i ndryshuar me ligjin nr. 178/2014, *“Për disa ndryshime dhe shtesa në ligjin nr.152/2013 “Për nëpunësin civil” si dhe Vendimin nr. 171, datë 26.03.2014 “Për transferimin e përhershëm dhe të përkohshëm të nëpunësve civilë, pezullimin dhe lirimin nga shërbimi civil” të Këshillit të Ministrave, Kreu III, “Transferimi për shkak të mbylljes dhe ristrukturimit të institucionit”*.

Në zbatim të Vendimit nr. 31, datë 31.03.2015, *“Për kryerjen e inspektimit në lidhje me zbatimin e ligjit në administrimin e shërbimit civil, si dhe në lidhje me procesin e ristrukturimit të institucionit, Këshilli i Qarkut Tiranë”*, të Komisionerit për Mbikëqyrjen e Shërbimit Civil, u ngrit grupi i inspektimit, i përbërë nga inspektorët Alda Xhaxhiu dhe Gentiana Biku, të cilët kanë bërë përpunimin e të dhënave dhe përgatitën projekt-raportin e inspektimit për këtë institucion, i cili iu dërgua për njohje Këshillit të Qarkut Tiranë, me shkresën nr. 290/3 prot., datë 26.05.2015, duke i lënë 5 ditë kohë për të paraqitur observacionet. Pas kësaj, projekt-raporti është nënshkruar pa vërejtje nga Kryetari i Qarkut Tiranë dhe Përgjegjësja e Sektorit Juridik dhe Administratës, duke shprehur vlerësimin e tyre për punën e kryer.

Oëllimi i inspektimit:

- Mbikëqyrja, kontrolli dhe vlerësimi i zbatimit të ligjit nr. 152/2013, *“Për nëpunësin civil”*, i ndryshuar me ligjin nr. 178/2014, *“Për disa ndryshime dhe shtesa në ligjin nr.152/2013 “Për nëpunësin civil”*, si dhe Vendimin nr.171, datë 26.03.2014, *“Për*

transferimin e përhershëm dhe të përkohshëm të nëpunësve civilë, pezullimin dhe lirimimin nga shërbimi civil” të Këshillit të Ministrave, Kreu III, “Transferimi për shkak të mbylljes dhe ristrukturimit të institucionit”;

- Paraqitja para përgjegjësve për administrimin e shërbimit civil, njësisë së burimeve njerëzore dhe titullarit të institucionit, e konstatimeve e fakteve të evidentuara dhe të vlerësuara si parregullsi në lidhje me zbatimin e ligjit për nëpunësin civil;
- Paralajmërimin e institucionit dhe personave përgjegjës, në rast të konstatimit të parregullsive gjatë zbatimit të ligjit, duke lënë edhe detyrat dhe rekomandimet përkatëse për përmirësimin e situatës, brenda një afati të arsyeshëm, sipas përcaktimeve të bëra në nenin 15 të ligjit nr. 152/2013, “Për nëpunësin civil”, të ndryshuar.

Objekti i inspektimit:

1. Si është kuptuar dhe zbatuar ligji nr. 152/2013, “Për nëpunësin civil”, i ndryshuar dhe aktet nënligjore të dala në bazë dhe për zbatim të tij, në lidhje me statusin e nëpunësve dhe punonjësve aktualë të institucionit në momentin e fillimit të efekteve të ligjit.
2. Plotësimi i kushteve ligjore të parashikuara në nenin 67 të ligjit nr. 152/2013 “Për nëpunësin civil”, i ndryshuar, në lidhje me statusin e punonjësve dhe nëpunësve aktualë, që do të verifikohet në këto aspekte:
 - Përfshirja e funksionit në shërbimin civil në përputhje me përshkrimin e punës dhe detyrat që realizon ky funksion;
 - Punonjësit ekzistues që janë punësuar në pozicione të shërbimit civil sipas këtij ligji, që janë rekrutuar sipas një procedure pranimit konkurruese, nëpërmjet procedurave të ngjashme me dispozitat e ligjit të mëparshëm nr. 8549, datë 11.11.1999, “Statusi i nëpunësit civil”, apo për një periudhë jo më të vogël se 1 vit;
 - Nëpunësit ekzistues që janë të punësuar në pozicione, pjesë të shërbimit civil, sipas këtij ligji, pa kaluar më parë në procedurë formale konkurruese ose që kanë më pak se një vit në këto pozicione pune;
 - Rastet e refuzimit të deklarimit të statusit të nëpunësit civil;
 - Si është dokumentuar procedura e ndjekur nga njësia përgjegjëse, në rastin e deklarimit të statusit të punësimit të punonjësve.
 - Si është dokumentuar në dosjen e personelit procedura e verifikimit dhe akti i deklarimit të statusit të punësimit nga njësia përgjegjëse, kërkesat e përgjithshme, kërkesat e posaçme, procedura e rekrutimit, akti i emërimit, etj.).
3. Respektimi i kërkesave ligjore në hartimin e formularit të përshkrimit të punës sipas formatit të përcaktuar nga ligji për nëpunësin civil dhe aktet nënligjore që kanë dalë në zbatim të tij, që do të verifikohet në këto aspekte:
 - Si është zbatuar procedura e hartimit të përshkrimit të punës dhe formati i miratuar me aktin nënligjor përkatës.
 - Nëpunësit që janë mbajtur pas ristrukturimit, në pozicione pune pjesë e shërbimit civil, i plotësojnë kërkesat e përgjithshme dhe të posaçme, të

përcaktuara në nenin 21 të ligjit nr. 152/2013, “Për nëpunësin civil”, i ndryshuar.

4. Procedura e ndjekur nga institucioni në lidhje me miratimin e planit vjetor të pranimit në shërbimin civil.
5. Rastet e rekrutimeve, lëvizjes paralele dhe ngritjes në detyrë, pas momentit të fillimit të efekteve juridike të ligjit nr. 152/2013, “Për nëpunësit civil”, i ndryshuar.
6. Respektimi i kërkesave specifike ligjore, gjatë procesit të përmbushjes së periudhës së provës (*detyrimet e nëpunësit dhe procedura e vendimmarrjes në përfundim të kësaj periudhe*).
7. Transferimi i përkohshëm dhe transferimi i përhershëm dhe si janë respektuar kërkesat ligjore në këto raste (*ristrukturimi dhe ngritja e komisionit përkatës, aktet që materializojnë procesin, si dhe rastet e tjera të transferimit*). Të saktësohet nëse ristrukturimi është bërë para apo pas deklaramentit të statusit të punësimit.
8. Pëzullimi nga shërbimi civil, sipas rasteve të parashikuara në ligj dhe si janë zbatuar kërkesat ligjore gjatë procedurës së zhvilluar në këto raste.
9. Masat disiplinore dhe respektimi i procedurës ligjore të kërkuar në fazat e zhvillimit të ecurisë disiplinore (kërkesa për fillimin e ecurisë, ngritja e Komisionit të përhershëm të disiplinës).
10. Përfundimi i marrëdhënies në shërbimin civil, referuar Kreut XII, “Përfundimi i marrëdhënies në shërbimin civil”, të ligjit nr. 152/2013, “Për nëpunësin civil”, i ndryshuar.
11. Probleme të ndryshme që i kanë lindur njësisë së menaxhimit të burimeve njerëzore (njësisë përgjegjëse), gjatë punës për zbatimin e ligjit nr. 152/2013, “Për nëpunësin civil”, i ndryshuar.

Metodologjia e inspektimit

Inspektimi përfshiu zbatimin e ligjit në administrimin e shërbimit civil, në lidhje me respektimin e kërkesave ligjore në procesin e deklaramentit të statusit të punësimit për çdo punonjës të institucionit, në momentin e fillimit të efekteve juridike të ligjit nr. 152/2013, “Për nëpunësin civil”, i ndryshuar, verifikimin e procesit të ristrukturimit të Këshillit të Qarkut Tiranë, praktikën e lirimit nga shërbimi civil të nëpunësve që iu është suprimuar pozicioni i punës apo iu janë ndryshuar kërkesat e posaçme dhe të përgjithshme, për shkak të ristrukturimit të institucionit, bazuar në ndryshimet strukturore të miratuara me Vendimin e Këshillit të Qarkut Tiranë me nr.216, datë 22.12.2014, “Për miratimin e strukturës organike të Administratës së Këshillit të Qarkut Tiranë”, masat disiplinore, etj.

Në zbatim të programit dhe drejtimit të inspektimit të përcaktuar në Vendimin nr. 31, datë 31.03.2015, të Komisionerit për Mbikëqyrjen e Shërbimit Civil, grupi i inspektimitverifikoi dhe shqyrtoi dokumentacionin mëposhtëm në raport me procedurat ligjore:

- Pozicionet e punës që janë pjesë e shërbimit civil, sipas organigramës dhe strukturës së institucionit;
- Procedurat e rekrutimit dhe përmbajtjen e dosjeve individuale të çdo nëpunësi civil, si dhe çdo të dhënë tjetër të kërkuar nga ligji për plotësimin e kërkesave të përgjithshme për pranimin në shërbimin civil;

- Përshkrimet dhe vlerësimet individuale të punës për pozicionet pjesë të shërbimit civil, nëse ato janë të hartuara në përputhje me formatin standart të miratuar;
- Të dhënat profesionale, si dhe të dhënat e tjera për marrëdhëniet e punës të çdo nëpunësi civil lidhur me përmbushjen e kërkesave të posaçme të vendit të punës si arsimi, përvoja në punë e të tjera;
- Aktet që materializojnë ndryshimet strukturore:
 - Vendimi nr.216, datë 22.12.2014, “Për miratimin e strukturës organike të Administratës së Këshillit të Qarkut Tiranë”.
 - Vendimi nr. 8, datë 29.12.2011, “Për miratimin e strukturës organike të Administratës së Këshillit të Qarkut Tiranë”.
 - Shkresa e Ministrisë së Financave me nr. 18081 prot., datë 24.12.2014 “Për tansfertën e pakushtëzuar për vitin 2015”.
 - Urdhri nr. 2, datë 05.01.2015, i Sekretarit të Përgjithshëm të Këshillit të Qarkut Tiranë, “Për ngritjen dhe përbërjen e Komisionit të Ristrukturimit”.
 - Rregullorja e Funksionimit të Brendshëm të Administratës së Këshillit të Qarkut të Tiranës, miratuar me Vendimin nr. 9, datë 29.12.2011.
 - Rregullorja e Funksionimit të Brendshëm të Administratës së Këshillit të Qarkut të Tiranës, miratuar me Vendimin nr. 218, datë 22.12.2014.
 - Relacion “Për Miratimin e Strukturës Organike të Administratës së Këshillit të Qarkut”.
 - Shkresa e Sektorit Juridik dhe Funksioneve të Deleguara të Prefektit të Qarkut Tiranë me nr. 6063/1 prot., datë 31.12.2014, për konfirmimin e ligjshmërisë së vendimeve të Këshillit të Qarkut Tiranë.
- Listëpagesat e muajit shkurt 2014 të të gjithë punonjësve të institucionit.
- Listëpagesat e muajit janar 2015 të të gjithë punonjësve të institucionit, si dhe materiale të tjera që kanë lidhje me procesin e inspektimit.

Konstatimet e inspektimit janë të materializuara si anekse më vete, në formën e tabelave dhe janë pjesë e këtij raporti simë poshtë:

- **Aneksi 1:** “Aktet që materializojnë procesin e njohjes së statusit për nëpunësit që punonin në pozicione të shërbimit civil, në momentin e fillimit të efekteve të ligjit nr. 152/2013, “Për nëpunësin civil”, me emërim të përkohshëm (data 26.02.2014)”.
- **Aneksi 2:** “Respektimi i kërkesave të përgjithshme sipas ligjit dhe i kërkesave të posaçme sipas formularit të përshkrimit të punës, për punonjësit që janë të emëruar aktualisht në pozicione pune pjesë e shërbimit civil në këtë institucion.
- **Aneksi 3:** “Aktet që materializojnë procesin e njohjes së statusit për nëpunësit që punonin në pozicione të shërbimit civil, në momentin e fillimit të efekteve të ligjit nr.152/2013, “Për nëpunësin civil”, të punësuar nëpërmjet konkurimit (data 26.02.2014)”.
- **Aneksi 4:** “Organigrama dhe historiku i marrëdhënies në shërbimin civil të punonjësve të Këshillit të Qarkut Tiranë”.

Përmbajtja e raportit:

I. Procesi i deklarimit të statusit të punësimit dhe plotësimi i kushteve ligjore për të përfituar statusin e nëpunësit civil, në përputhje me kërkesat e nenit 67 të ligjit nr. 152/2013, “Për nëpunësin civil”, të ndryshuar dhe akteve nënligjore në zbatim të tij

1. Situata e administrimit të burimeve njerëzore në momentin e inspektimit.

Ligji nr.152/2013 “Për nëpunësin civil”, i ndryshuar, vendos rregulla të qarta për mënyrën e administrimit të shërbimit civil, për të gjitha institucionet që hyjnë në fushën e veprimit të tij. Në nenin 2 të këtij ligji përcaktohet se ky ligj zbatohet për çdo nëpunës që ushtron një funksion publik në një institucion të administratës shtetërore, institucion të pavarur apo njësi të qeverisjes vendore, por njëkohësisht evidentohen dhe rastet përjashtimore për disa funksione të identifikuar shprehimisht në këtë dispozitë të ligjit.

Këshilli i Qarkut Tiranë, është krijuar dhe funksionon si organ përfaqësues i Qarkut, mbi bazën e ligjit nr. 8652, datë 31.07.2000, “Për organizimin dhe funksionimin e qeverisjes vendore”, ndryshuar me ligjin nr. 9208, datë 18.03.2004, i cili në nenet 5 dhe 6 të tij, e përcakton atë si njësi të qeverisjes vendore, e për këtë arsye ky institucion përfshihet në fushën e veprimit të ligjit për nëpunësin civil.

Administrata e Këshillit të Qarkut funksionon mbi bazën e strukturës organizative të miratuar nga Këshilli i Qarkut, sipas parashikimeve të nenit 54 të ligjit nr. 8652, datë 31.07.2000, “Për organizimin dhe funksionimin e qeverisjes vendore”, ku përcaktohen detyrat dhe kompetencat e Këshillit të Qarkut.

Në rastin konkret, subjekti i inspektimit funksionon sipas strukturës organizative të miratuar me Vendimin nr.216, datë 22.12.2014, “Për miratimin e strukturës organike të Administratës së Këshillit të Qarkut Tiranë” të Këshillit të Qarkut Tiranë, ndërsa në momentin e hyrjes në fuqi të ligjit nr. 152/2013, “Për nëpunësin civil”, i ndryshuar, në datë 26.02.2014, Këshilli i Qarkut Tiranë ka funksionuar sipas strukturës organizative të miratuar me Vendimin nr. 8, datë 29.12.2011 “Për miratimin e strukturës organike të Administratës së Këshillit të Qarkut Tiranë”, të Këshillit të Qarkut Tiranë.

Sipas strukturës së miratuar me Vendimin nr. 216, datë 22.12.2014, “Për miratimin e strukturës organike të Administratës së Këshillit të Qarkut Tiranë”, Administrata e Këshillit të Qarkut Tiranë ka gjithsej **34** pozicione pune. Duke patur parasysh klasifikimin e pozicioneve në shërbimin civil, sipas përcaktimeve të nenit 19 të ligjit nr. 152/2013, “Për nëpunësin civil”, i ndryshuar, si dhe Vendimin nr.142, datë 12.03.2014, “Për përshkrimin dhe klasifikimin e pozicioneve të punës në institucionet e administratës shtetërore dhe institucionet e pavarura”, rezulton se në këtë institucion **12** janë pozicione mbështetëse, të cilat gjejnë rregullim ligjor në bazë të Kodit të Punës së Republikës së Shqipërisë, si dhe **22** pozicione pune pjesë e shërbimit civil, të cilat ndahen në këto kategori:

- Nëpunës civilë të nivelit të lartë drejtues është **1** pozicion, i cili i përket pozicionit “Sekretar i Përgjithshëm”.
- Nëpunës civilë të nivelit të mesëm drejtues janë **3** pozicione pune, të cilat i përkasin pozicionit “Drejtor Drejtorie”.
- Nëpunës civilë të nivelit të ulët drejtues janë **4** pozicione pune, të cilat i përkasin pozicionit “Përgjegjës sektori/ Kryeinspektor”.
- Nëpunës civilë të nivelit ekzekutiv janë **14** pozicione pune, të cilat i përkasin pozicionit “Specialist/Inspektor”.

Në lidhje me metodologjinë e ndjekur për klasifikimin e pozicioneve të punës në këtë institucion, Komisioneri për Mbikëqyrjen e Shërbimit Civil vlerëson se është bërë një ndarje e drejtë si ndërmjet funksioneve drejtuese dhe atyre ekzekutive, ashtu edhe midis pozicioneve të punës që janë pjesë e shërbimit civil, me ato që kryejnë funksione administrative.

Por, nga na tjetër, duhej të tregohej kujdes me emërtesat dhe konkretisht, për dy raste:

- ***** - në pozicionin “Drejtor dhe Përgjegjës Finance në Drejtorinë e Financës, Çështjeve Ligjore dhe Administratës”.
- ***** - në pozicionin “Drejtor dhe Përgjegjës për Planifikimin Urban dhe Mjedisin në Drejtorinë e Planifikimit Urban, Mjedisit, Transportit, Infrastrukturës dhe Zhvillimit Rajonal”.

Konkluzion: Komisioneri për Mbikëqyrjen e Shërbimit Civil vlerëson se Njësia e personelit në bashkëpunim me Sekretarin e Përgjithshëm, duhet të rishikojë emërtesat e këtyre pozicioneve dhe të bëjë unifikimin e emërtimeve sipas kërkesave të ligjit nr. 90/2012, “Për organizimin dhe funksionimin e administratës shtetërore”, sepse nuk mund të ketë një pozicion pune me dy emërtesa, edhe *Drejtor* edhe *Përgjegjës*. Komisioneri për Mbikëqyrjen e Shërbimit Civil rekomandon që ky rast duhet të trajtohet si gabim material dhe për këtë të dalë një akt administrativ nga ana e titullarit për rregullimin dhe unifikimin e emërtesës.

2. Si është kuptuar dhe zbatuar neni 67 i ligjit nr.152/2013, “Për nëpunësin civil”, i ndryshuar dhe aktet nënligjore në zbatim të tij

Nisur nga fakti që Këshilli i Qarkut Tiranë është pjesë e shërbimit civil, deklarimi si nëpunës civil ekzistues për çdo punonjës të këtij institucioni, duhet të bëhet në respektim të kërkesave të përcaktuara në ligjin nr. 152/2013, “Për nëpunësin civil”, i ndryshuar dhe konkretisht të nenit 67, pikat 3, 4 dhe 6, ku përcaktohet në mënyrë të shprehur se:

- *pika 3*, “Nëpunësit civilë ekzistues, punonjësit ekzistues, që janë të punësuar në pozicione të shërbimit civil, sipas këtij ligji dhe që janë rekrutuar sipas një procedure pranimit konkurruese, të ngjashme me atë të përcaktuar nga ligji nr.8549, datë 11.11.1999 “*Statusi nëpunësit civil*”, apo që janë të punësuar në të njëjtin vend pune për një periudhë jo më të vogël se 1 vit, janë, për shkak të ligjit, nëpunës civilë”;
- *pika 4* “Nëpunësit ekzistues, që janë të punësuar në pozicione pune, pjesë e shërbimit civil, sipas këtij ligji dhe që nuk plotësojnë kushtet e parashikuara në pikën 3 të këtij neni,

janë nëpunës civilë në periudhë prove dhe për ta zbatohen dispozitat e nenit 24 të këtij ligji. Periudha e provës fillon nga fillimi i shtrirjes së efekteve të këtij ligji”;

- *pika 6 “Deklarimi i statusit të punësimit, sipas pikave 1, 3 dhe 4 të këtij neni, bëhet nga njësia përgjegjëse pas verifikimit të procedurës së punësimit”.*

Po kështu, në Vendimin nr. 116, datë 05.03.2014 të Këshillit të Ministrave, “Për statusin e nëpunësve dhe punonjësve aktualë që përfitojnë statusin e nëpunësit civil sipas ligjit nr. 152/2013 “Për nëpunësin civil”, i ndryshuar, Kreu II, “Statusi i nëpunësve të tjerë civilë në institucionet e administratës shtetërore, institucionet e pavarura, bashkitë dhe qarqet”, pika 1, është përcaktuar se: “Nëpunës civil”, sipas pikës 3 të nenit 67, janë të gjithë ata nëpunës që kryejnë funksione të shërbimit civil në momentin e fillimit të efekteve të ligjit nr. 152/2013 dhe që janë rekrutuar sipas procedurave konkurruese, përcaktuar nga ligji nr. 8549, datë 11.11.1999 “Statusi i nëpunësit civil”.

Këto janë dispozitat bazë që duhet të mbajë parasysh njësi përgjegjëse për të realizuar drejt detyrimin ligjor të deklaramit të statusit të punësimit.

Për të arritur në një konkluzion të saktë lidhur me veprimet e kryera nga njësi e burimeve njerëzore, si njësi përgjegjëse për administrimin e shërbimit civil, nëse veprimet administrative të kryera janë në përputhje me kërkesat e ligjit, Komisioneri për Mbikëqyrjen e Shërbimit Civilverifikoi dhe analizoi materialet shpresore që përmbajnë të dhëna lidhur me pozicionet pjesë e shërbimit civil, si organigramën dhe strukturën analitike të institucionit që ka qenë në fuqi në momentin e shtrirjes së efekteve të ligjit të miratuar me Vendimin nr. 8, datë 29.12.2011, “Për miratimin e strukturës organike të Administratës së Këshillit të Qarkut Tiranë”.

Sipas strukturës së miratuar me Vendimin nr. 8, datë 29.12.2011, “Për miratimin e strukturës organike të Administratës së Këshillit të Qarkut Tiranë”, Administrata e Këshillit të Qarkut Tiranë kishte gjithsej **56** pozicione pune. Duke patur parasysh klasifikimin e pozicioneve në shërbimin civil, sipas përcaktimeve të nenit 19, të ligjit nr. 152/2013, “Për nëpunësin civil”, i ndryshuar, rezulton se në këtë institucion ishin **41** pozicione pune pjesë e shërbimit civil, të cilat ndahen në këto kategori:

- **2** (dy) Sekretar i Përgjithshëm dhe Drejtor i Përgjithshëm (nëpunës civil të kategorisë së lartëdrejtuese);
- **5** (pesë) Drejtorë (nëpunës civil të kategorisë së mesme drejtuese);
- **5** (pesë) Përgjegjës Sektor/Kryeinspektor (nëpunës civil të nivelit të ulët drejtues);
- **29** (njëzetë e nëntë) Audit i brendshëm/Specialistë/Inspektorë (nëpunës civil të kategorisë ekzekutive).

2 inspektorët e Agjensisë së Inventarizimit dhe Transferimit të Pronave janë në kuadër të funksioneve të deleguara (nëpunës civil të kategorisë ekzekutive) (Vendimi nr. 500, datë 14.08.2001, i Këshillit të Ministrave, “Për inventarizimin e pronave të paluajtshme shtetërore dhe transferimin e pronave në njësitë e qeverisjes vendore”), të rekrutuar sipas Kodit të Punës. Këto pozicione me strukturën e retë miratuar me Vendimin nr. 216, datë 22.12.2014, “Për

miratimin e strukturës organike të Administratës së Këshillit të Qarkut Tiranë”, nuk ekzistojnë më dhe për këtë arsye, për punonjësit:

1. ***** – në pozicionin *Specialist* në Degën e AITPP në Qarkun Tiranë (urdhër i Ministrisë të Brendshme me nr. 290, datë 05.03.2007)
2. ***** - në pozicionin *Specialist* në Degën e AITPP në Qarkun Tiranë (urdhër i Sekretarit të Përgjithshëm të Ministrisë së Brendshme me nr. 2606, datë 01.08.2006)

është urdhëruar përfundimi i marrëdhënies së punës.

Me vendimin nr. 26, datë 04.06.2012, “Për një ndryshim në vendimin e Këshillit të Qarkut nr. 8, datë 29.12.2011 “Për miratimin e strukturës organike të administratës së Këshillit të Qarkut Tiranë”, struktura e Këshillit të Qarkut Tiranë është shkurtuar me 1 punonjës (konkretisht pozicioni i Auditit të Brendshëm është suprimuar), për rrjedhojë, punonjësja ***** , pas ristrukturimit me vendimin nr. 32 (nr. 1678 prot.), datë 19.06.2012, është emëruar në pozicionin *Specialiste Ekonomie*, pranë Sektorit të Infrastrukturës dhe Transportit. Në këtë moment, në këtë strukturë ka edhe **3** (tre) vende vakante.

Në lidhje me sa më sipër, njësia përgjegjëse ka nxjerrë aktet e deklaramit të statusit të nëpunësit për **37** punonjës të administratës të Këshillit të Qarkut, të detajuar si më poshtë:

- në **24** raste, për punonjësit është deklaruar statusi si nëpunës civilë;
- në **11** raste, për punonjësit është deklaruar statusi si nëpunës civilë në periudhë prove;
- në **2** raste është lënë afati ligjor për plotësimin e kriterit të përputhjes së arsimit me pozicionin e punës (sipas VKM nr. 532, datë 06.08.2014 “Për disa shtesa dhe ndryshime në VKM nr. 116, datë 05.03.2014”).

Në përfundim të kësaj analize, statusin e punësimit të punonjësve të këtij institucioni, sipas strukturës që ka qenë në fuqi në momentin e fillimit të efekteve të ligjit nr. 152/2013, “Për nëpunësin civil”, i ndryshuar, mund të kategorizojmë në këtë mënyrë:

- a. Nëpunës, të cilët janë rekrutuar sipas procedurave konkurruese, përcaktuar në ligjin nr. 8549/1999, “Statusi i nëpunësit civil” dhe nëpunës të cilët kanë përfituar nga fillimi i efekteve të ligjit nr. 152/2013, “Për nëpunësin civil”.

Nga këqyrja e akteve të administruara dhe përmbajtja e tyre rezulton se në të gjitha rastet janë respektuar procedurat ligjore të kërkuara nga ky ligj. Kështu, është shpallur pozicioni i lirë në dy gazetatat me qarkullimin më të madh; është krijuar komiteti *ad hoc*; ka dalë akti i përzgjedhjes dhe i emërimit, si dhe akti i konfirmimit si nëpunës civilë.

- Në respektim të kërkesave të pikës 3 të nenit 67 të ligjit nr. 152/2013, “Për nëpunësin civil”, i ndryshuar, si dhe pikës 1 të Vendimit nr. 116, datë 05.03.2014, të Këshillit të Ministrave, “Për statusin e nëpunësve dhe punonjësve aktualë që përfitojnë statusin e nëpunësit civil sipas ligjit nr. 152/2013, “Për nëpunësin civil”, Kreu II, “Statusi i nëpunësve të tjerë civilë në institucionet e administratës shtetërore, institucionet e pavarura, bashkitë dhe qarqet”, punonjësit që kanë përfituar statusin e nëpunësit civil në këtë kategori janë **24**:

1. ***** në pozicionin “Drejtor në Drejtorinë e Financës dhe Buxhetit”
2. ***** në pozicionin “Drejtor në Drejtorinë e Planifikimit Urban, Mjedisit, Transportit, Infrastrukturës dhe Zhvillimit Rajonal”
3. ***** në pozicionin “Specialist për Administrimin Financiar në Drejtorinë e Financës dhe Buxhetit”
4. ***** në pozicionin “Specialist për Buxhetin në Drejtorinë e Financës dhe Buxhetit”
5. ***** në pozicionin “Specialist i Çështjeve të Pronësisë në Drejtorinë e Shërbimit të Çështjeve Ligjore dhe Personelit”
6. ***** në pozicionin “Specialist i Çështjeve Administrative në Drejtorinë e Shërbimit të Çështjeve Ligjore dhe Personelit”
7. ***** në pozicionin “Drejtor në Drejtorinë e Shërbimit të Çështjeve Ligjore dhe Personelit”
8. ***** në pozicionin “Specialist për Kulturën në Drejtorinë e Zhvillimit Rajonal”
9. ***** në pozicionin “Specialist i Kadastrës Urbane në Drejtorinë e Planifikimit Urban, Infrastrukturës dhe Transportit”
10. ***** në pozicionin “Specialist për Bujqësinë dhe Mjedisin në Drejtorinë e Zhvillimit Rajonal”
11. ***** në pozicionin “Përgjegjës Sektori në Drejtorinë e Planifikimit Urban, Infrastrukturës dhe Transportit”
12. ***** në pozicionin “Përgjegjës për Administrimin e Tokës në Drejtorinë e Administrimit dhe Mbrojtjes së Tokës”
13. ***** në pozicionin “Specialist për Arshivën Kavajë në Drejtorinë e Administrimit dhe Mbrojtjes së Tokës”
14. ***** në pozicionin “Specialist për Axhornimin Topografik e Kadastral në Drejtorinë e Administrimit dhe Mbrojtjes së Tokës”
15. ***** në pozicionin “Kryeinspektor në Inspektoriatin e Mbrojtjes së Tokës”
16. ***** në pozicionin “Specialist Urbanistike në Drejtorinë e Planifikimit Urban, Infrastrukturës dhe Transportit”
17. ***** në pozicionin “Specialist i Kontrollit të Projekteve Drejtorinë e Planifikimit Urban, Infrastrukturës dhe Transportit”
18. ***** në pozicionin “Specialist për Arshivën në Drejtorinë e Planifikimit Urban, Infrastrukturës dhe Transportit”
19. ***** në pozicionin “Specialist Transporti në Drejtorinë e Planifikimit Urban, Infrastrukturës dhe Transportit”
20. ***** në pozicionin “Specialist për Investimet e Huaja në Drejtorinë e Zhvillimit Rajonal”
21. ***** në pozicionin “Specialist për Projektet në Drejtorinë e Zhvillimit Rajonal”
22. ***** në pozicionin “Specialist për Marrëdhëniet me Jashtë në Drejtorinë e Zhvillimit Rajonal”
23. ***** në pozicionin “Specialist për Politikën Sociale në Drejtorinë e Zhvillimit”

24. ***** në pozicionin “*Specialist i Teknologjisë dhe Informacionit në Drejtorinë e Zhvillimit*”

- Në respektim të kërkesave të pikës 4të nenit 67 të ligjit nr.152/2013, “*Për nëpunësin civil*” i ndryshuar si dhe Vendimit nr. 116, datë 05.03.2014, të Këshillit të Ministrave, “*Për statusin e nëpunësve dhe punonjësve aktualë që përfitojnë statusin e nëpunësit civil sipas ligjit nr. 152/2013, “Për nëpunësin civil”, i ndryshuar, punonjësit që kanë përfituar statusin e nëpunësit civil në periudhë prove në këtë kategori janë 11:*

1. ***** në pozicionin “*Specialist për Marrëdhëniet me Publikun në Drejtorinë e Financës, Çështjeve Ligjore dhe Administratës*”
2. ***** në pozicionin “*Specialist për Zhvillimin Rajonal në Drejtorinë e Planifikimit Urban, Infrastrukturës dhe Transportit*”
3. ***** në pozicionin “*Drejtor i Drejtorisë së Administrimit dhe Mbrojtjes së Tokës*”
4. ***** në pozicionin “*Specialist për Arshivën (Tiranë), në Drejtorinë e Administrimit dhe Mbrojtjes së Tokës*”
5. ***** në pozicionin “*Specialist Ekonomik në Sektorin e Infrastrukturës dhe Transportit*”
6. ***** në pozicionin “*Specialist për Emergjencat dhe Statusin e Dëshmorit në Drejtorinë e Shërbimit të Çështjeve Ligjore dhe Personelit*”
7. ***** në pozicionin “*Specialist për Prokurimet në Drejtorinë e Shërbimit të Çështjeve Ligjore dhe Personelit*”
8. ***** në pozicionin “*Specialist Infrastrukture në Drejtorinë e Planifikimit Urban, Infrastrukturës dhe Transportit*”
9. ***** në pozicionin “*Drejtor i Përgjithshëm*”
10. ***** në pozicionin “*Inspektornë Inspektoriatin e Mbrojtjes së Tokës*”
11. ***** në pozicionin “*Specialist për Arsimin dhe Shëndetsinë në Drejtorinë e Zhvillimit*”

Konkluzion: Komisioneri për Mbikëqyrjen e Shërbimit Civil vlerëson se, njësia përgjegjëse, e ngarkuar nga ligji për të formalizuar aktin e deklarimit të statusitka vepruar konform nenit 67 të ligjit nr.152/2013, “*Për nëpunësin civil*”, i ndryshuar, duke nxjerrë në afat aktet e deklarimit të statusit të punësimit.

Konstatohen parregullsi gjatë vendimarrjes, në lidhje me konfirmimin si nëpunës civil të punonjësve në përfundim të periudhës së provës. Në zbatim të nenit 24 të ligjit 152/2013, “*Për nëpunësin civil*”, i ndryshuar, Kreut VI “*Periudha e provës*” të Vendimit nr. 243, datë 18.03.2015, “*Për pranimin, lëvizjen paralele, periudhën e provës dhe emërimin në kategorinë ekzekutive*”, vendimi në përfundim të periudhës së provës merret bazuar në:

- a) *Rezultatit e testimit në përfundim të ciklit të detyrueshëm të trajnimit në ASPA;*
- b) *Vlerësimin e rezultateve individuale në punë, i cili bëhet sipas procedurave të përcaktuara në vendimin e Këshillit të Ministrave për vlerësimin e arritjeve vjetore;*

Vendimi i konfirmimit si nëpunës civil nga Sekretari i Përgjithshëm është marrë në kundërshtim të dispozitës së mësipërme ligjore, pasi në dosjet personale të punës nuk rezultojnë certifikata e trajnimit të detyrueshëm të ASPA-s dhe vlerësimi i rezultateve individuale në punë. Në këtë rast njësia përgjegjëse konform nenit 115 e vijues të Kodit të Procedurave Administrative duhet të bëjë revokimin e vendimit të konfirmimit si nëpunës civil dhe përsëritjen e periudhës së provës, e cila do të fillojë nga momenti i marrjes dijeni të vendimit të Komisionierit për Mbikëqyerjen Shërbimit Civil, si dhe kryerjen menjëherë të trajnimit të detyrueshëm të ASPA-s përkatësisht për punonjësit e mëposhtëm:

- ***** (vendimi nr. 20, datë 29.01.2015),
 - ***** (vendimi nr. 23, datë 03.02.2015),
 - ***** (vendimi nr. 22, datë 02.02.2015).
- Në respektim të VKM nr. 532, datë 06.08.2014, "*Për disa shtesa dhe ndryshime në VKM nr. 116, datë 05.03.2014*") për 2 raste është lënë afati ligjor për plotësimin e kriterit të përputhjes së arsimit me pozicionin e punës, konkretisht:
 1. ***** në pozicionin "*Specialist Transporti në Drejtorinë e Planifikimit Urban, Infrastrukturës dhe Transportit*"
 2. ***** në pozicionin "*Përgjegjëse Sektori në Drejtorinë e Zhvillimit*"
- b. Pozicione pune pjesë e shërbimit civil, të plotësuara me akte të përkohshme emërimi përpara hyrjes në fuqi të ligjit nr. 152/2013, "Për nëpunësin civil", i ndryshuar.**

Nga analiza e materialeve të verifikuara, rezulton se 2 pozicione punepjesë e shërbimit civil në këtë institucion janë plotësuar me akte emërimi të përkohshëm sipas dispozitave të ligjit nr. 7961, datë 12.07.1995, "*Kodi i Punës i Republikës së Shqipërisë*", i ndryshuar, duke mos respektuar procedurat e parashikuara në nenin 13 të ligjit nr. 8549, datë 11.11.1999, "*Statusi i nëpunësit civil*", konkretisht:

b/1. - 1 punonjës në pozicionin "*Sekretari i Përgjithshëm*", që është edhe pozicioni më i lartë i nëpunësit në shërbimin civil, rezulton se ndodhet në këtë pozicion pa kryer procedurat e konkurrimit

Konkretisht punonjësi ***** i cili është deklaruar si nëpunës civil me aktin administrativ nr. 683, datë 13.06.2014 ka filluar punë në institucionin e Këshillit të Qarkut Tiranë, me Urdhrin e Brendshëm të titullarit nr. 27, datë 19.06.2012, "*Për emërimin e punonjësit ***** në detyrën e Sekretarit të Përgjithshëm të Këshillit të Qarkut Tiranë*", duke mos specifikuar periudhën kohore për të cilin do të kryente këtë detyrë.

b/2. - 1 punonjës në pozicionin "*Përgjegjëse e Sektorit të Marrëdhënieve me Bashkitë dhe Komunitat në Drejtorinë e Zhvillimit Rajonal*", që është emëruar me urdhër të brendshëm të titullarit dhe me kontratë të përkohshme, në kushte emergjente, deri në përfundim të procedurave të konkurrimit.

Konkretisht punonjësja ***** ka filluar punë në institucion, me Urdhrin e Brendshëm nr. 16 (nr. 226 prot.), datë 10.02.2014, të titullarit, për një periudhë të përkohshme, justifikuar me kushtet e emergjencës, deri në përfundim të procedurave të konkurimit në pozicionin "*Përgjegjëse e Sektorit të Marrëdhënieve me Bashkitë dhe Komunitat në Drejtorinë e Zhvillimit Rajonal*". Akti i deklarimit të statusit të punësimit vërtetohet nga përmbajtja e relacionit nr.

682/6 prot., datë 11.08.2014, “Relacion mbi verifikimin e procedurës së rekrutimit dhe deklarimit të punësimit aktual të *****”. Kjo punonjëse, aktualisht, pas ristrukturimit është riemëruar, në pozicionin *Specialist për Marrëdhëniet me Njësitë Vendore dhe Zgjedhjet në Drejtorinë e Planifikimit Urban, Mjedisit, Transportit, Infrastrukturës dhe Zhvillimit Rajonal*.

II. Procesi i ristrukturimit i Këshillit të Qarkut Tiranë

Kriteret bazë mbi të cilat është bërë vlerësimi i ligjshmërisë së procesit të ristrukturimit (*aktet e lirimimit të nëpunësve të cilëve u është suprimuar pozicioni i punës dhe aktet e riemërimit të nëpunësve të mbetur pas ristrukturimit, që plotësojnë kërkesat e veçanta dhe të përgjithshme për pozicionin e ri të punës, sipas përshkrimeve të reja*) janë kushtet e parashikuara në nenin 50 të ligjit nr. 152/2013 “Për nëpunësin civil”, i ndryshuar, si dhe Vendimit nr.142, datë 12.03.2014, “Për përshkrimin dhe klasifikimin e pozicioneve të punës në institucionet e administratës shtetërore dhe institucionet e pavarura”, të Këshillit të Ministrave dhe Vendimin nr.171, dt.26.03.2014, “Për transferimin e përhershëm dhe të përkohshëm të nëpunësve civilë, pezullimin dhe lirim nga shërbimi civil” të Këshillit të Ministrave dhe konkretisht:

- Nëpunësit e riemëruar pas procesit të ristrukturimit të institucionit janë deklaruar si nëpunës civilë, në përputhje me kërkesat e nenit 67 pika 3 dhe 6 të ligjit nr. 152/2013, “Për nëpunësin civil”, i ndryshuar, dhe në cilin pozicion pune ka qenë secili nëpunës para procesit të ristrukturimit dhe në cilin pozicion është sistemuar pas tij.
- Akt-Verifikimi mbi përmbajtjen e dosjesve së personelit dhe deklarimin e statusit të nëpunësve që përfshihen në fushën e veprimit të ligjit nr. 152/2013, “Për nëpunësin civil”, i ndryshuar.
- Përshkrimet e pozicioneve të punës dhe kërkesat e përgjithëshme e të veçanta të këtyre pozicioneve dhe verifikimi i përputhshmërisë së tyre me karakteristikat personale të nëpunësve që janë riemëruar aktualisht në këto pozicione.

Sipas përmbajtjes së nenit 50 të ligjit nr. 152/2013, “Për nëpunësin civil” i ndryshuar; Vendimit nr. 171, datë 26.03.2014, “Për transferimin e përhershëm dhe të përkohshëm të nëpunësve civilë, pezullimin dhe lirim nga shërbimi civil” të Këshillit të Ministrave dhe Vendimit nr.142, datë 12.03.2014, “Për përshkrimin dhe klasifikimin e pozicioneve të punës në institucionet e administratës shtetërore dhe institucionet e pavarura” të Këshillit të Ministrave, është njësia përgjegjëse ajo që drejton gjithë procesin nga ana ligjore: krijon komisionin e ristrukturimit dhe ka detyrimin ligjor për marrjen e vendimit përfundimtar për lirim nga shërbimi civil të nëpunësve që u është shkurtuar pozicioni i punës apo që u është ristrukturuar për shkak të ndryshimit të përshkrimit dhe kërkesave të përgjithëshme e të veçanta të vendit të punës.

Në rastin konkret, në zbatim të ligjit nr. 152/2013, “Për nëpunësin civil” i ndryshuar, me Urdhrin nr. 2, datë 05.01.2015, të Sekretarit të Përgjithshëm të Këshillit të Qarkut Tiranë, “Për ngritjen dhe përbërjen e komisionit të ristrukturimit”, është ngritur komisioni për kryerjen e procedurës përkatëse ligjore.

Konkluzion: Komisioneri për Mbikëqyrjen e Shërbimit Civil konstaton se në institucion nuk gjenden përshkrimet e pozicioneve të punës, edhe pse në aktverifikimin e dosjes së personelit dhe deklarimin e statusit të nëpunësit civil (akt i cili shoqëronte praktikën e nëpunësve të liruar) në pikën 5 të tij, theksohej se procedura për secilin lirim nga shërbimi civil apo riemërim pas

ristrukturimit ishte bërë duke analizuar me hollësisht karakteristikat e veçanta të secilit nëpunës në raport me kriteret dhe kërkesat e përgjithshme e të veçanta të pozicioneve të punës, të mbetura pas ristrukturimit. Për sa më sipër konkludohet se, mungesa e përshkrimeve të punës për secilin pozicion pune, duke u bazuar vetëm tek një rregullore e brendshme e institucionit, me një karakter të përgjithshëm dhe qënë të nuk përfshihen të gjitha pozicionet e punës, krijon vështirësi, mungesë transparence dhe paqartësi në procesin e vlerësimit krahasues të kërkesave të përgjithshme e të veçanta të pozicioneve të punës me karakteristikat personale të nëpunësve të prekur (të liruar/riemëruar) nga ristrukturimi.

Në këtë vështrim mbetet detyrë për plotësimin e menjëhershëm të gjithë përshkrimeve të punës sipas formatit të ligjit nr. 152/2013, “Për nëpunësin civil”, i ndryshuar, dhe VKM nr. 142, datë 12.03.2014, “Për përshkrimin dhe klasifikimin e pozicioneve të punës në institucionet e administratës shtetërore dhe institucionet e pavarura” dhe pas kësaj duhet të bëhen të njohura dhe të vendosen në dosjen personale të secilit nëpunës të punësuar.

Pas kontrollit të ushtruar në lidhje me procesin e vlerësimeve vjetore të nëpunësve, në zbatim të nenit 62 të ligjit nr. 152/2013, “Për nëpunësin civil”, i ndryshuar, dhe Vendimit të Këshillit të Ministrave nr. 109, datë 26.02.2014, “Për vlerësimin e rezultateve në punë të nëpunësve civil”, u konstatua se, vlerësimet e rezultateve individuale nëpunë, për vitin 2012 – 2013, të gjithë nëpunësve civil të Këshillit të Qarkut Tiranë ishin me nivelin 1 “shumë mirë”, gjë që pavarësisht vështirësisë për të matur nga jashtë saktësinë dhe eficiencën e akteve të kësaj natyre të eprorit, tregon për elemente të një qëndrim subjektiv dhe formal. Veç kësaj në dosjet e personelit nuk ka vlerësime për vitin 2013 – 2014, nga ku rezulton se për këtë periudhë nuk ka një vlerësim për këta nëpunës në zbatim të nenit 62 të ligjit nr. 152/2013, “Për nëpunësin civil”, i ndryshuar, dhe Vendimit të Këshillit të Ministrave nr. 109, datë 26.02.2014, “Për vlerësimin e rezultateve në punë të nëpunësve civil”. Nga sa më sipër konstatohet një qëndrim i pakujdesëshëm në kryerjen e detyrës si nga njësia e personelit ashtu dhe nga ana e eprorëve direkt. Kjo mangësi, duhet të plotësohet menjëherë, pavarësisht kalimit të afateve të përcaktuara nga ligji. Të gjithë punonjësit e mbajtur pas ristrukturimit, duhet të pajisen me vlerësimet e punës për vitin 2013 – 2014, pasi kjo është jo vetëm një detyrim ligjor i paplotësuar, por është një mangësi që mund të krijojë pengesa, për nëpunësin civil në rastet e lëvizjeve paralele, apo ngritjes në detyrë, etj.

Sa më sipër të kryhen vlerësimet vjetore të punës për çdo punonjës në zbatim të nenit 62 të ligjit nr. 152/2013, “Për nëpunësin civil”, i ndryshuar, dhe VKM nr. 109, datë 26.02.2014, “Për vlerësimin e rezultateve në punë të nëpunësve civil”. Komisioneri për Mbikëqyrjen e Shërbimit Civil rekomandon që vlerësimet vjetore të punës të kryhen me objektivizëm, duke respektuar procedurën e parashikuar në aktet ligjore e nënligjore përkatëse, me qëllim që të evitohet njëjësimi në vlerësimet maksimale, pa e mbështetur këtë në rezultatet dhe arritjet në përmbushjen e objektivave, me qëllim stimulimin dhe rritjen e performancës në punë.

1/a Struktura organizative e Këshillit të Qarkut Tiranë para procesit të ristrukturimit.

Nga tërësia e materialeve shkresore të vëna në dispozicion gjatë inspektimit dhe nga verifikimi i tyre dhe ballafaqimi me ligjin rezultoi se:

Sipas strukturës, së mëparshme, të miratuar me Vendimin nr. 8, datë 29.12.2011, “Për miratimin e strukturës organike të Administratës së Këshillit të Qarkut Tiranë”, numri i përgjithshëm i punonjësve ishte **56** punonjës, nga të cilët **41** pozicione, përfshiheshin në fushën e veprimit të ligjit për shërbimin civil.

Struktura e aparatit administrativ të institucionit kishte organizimin e mëposhtëm:

- I. Sekretar i Përgjithshëm
- II. Auditi i Brendshëm
- III. Drejtor i Përgjithshëm

- IV. Drejtoria e Planifikimit Urban, Infrastrukturës dhe Transportit, me organikë **1** Drejtor, në përbërje të së cilës janë **2** sektorë e konkretisht:
1- Sektori i Planifikimit Urban, me organikë **4** specialistë.
2- Sektori i Infrastrukturës dhe Transportit me organikë **1** përgjegjës sektori dhe **2** specialistë.

- III. Drejtoria e Zhvillimit Rajonal, me organikë **1** Drejtor, në përbërje të së cilës janë **2** sektorë e konkretisht:
1- Sektori i Bashkëpunimit me Jashtë, me organikë **4** specialistë.
2- Sektori i Marrëdhënieve për Bashkitë dhe Komunat, me organikë **1** përgjegjës sektori dhe **4** specialistë.

- IV. Drejtoria e Shërbimeve, Çështjeve Ligjore dhe Personelit me organikë **1** Drejtor, në përbërje të së cilës janë **2** sektorë e konkretisht:
1- Sektori i Shërbimeve dhe Personelit, me organikë **4** specialistë.
2- Sektori i Çështjeve Ligjore, me organikë **1** përgjegjës sektori dhe **2** specialistë.

- V. Drejtoria e Financës dhe Buxhetit, me organikë **1** drejtor dhe **3** specialistë.

- VI. Drejtoria e Administrimit dhe Mbrojtjes së Tokës, me organikë **1** drejtor, **1** përgjegjës sektori dhe **3** specialistë.

- VII. Inspektoriati i Mbrojtjes së Tokës me organikë **1** kryeinspektor dhe **2** inspektorë.

- VIII. Agjensia e Inventarizimit dhe Transferimit të Pronave me organikë **2** inspektorë.

Sa sipër rezulton se numri i përgjithshëm i nëpunësve civilë ishte **41** (dyzetë e një), nga të cilët :

- **2** (dy) Sekretar i Përgjithshëm dhe Drejtor i Përgjithshëm (*nëpunës civilëtë kategorisë së lartëdrejtuese*) ;
- **5** (pesë) Drejtorë (*nëpunës civilëtë kategorisë së mesme drejtuese*);
- **5** (pesë) Përgjegjës Sektori/Kryeinspektor (*nëpunës civilëtë nivelit të ulët drejtues*);
- **29** (*njëzetë e nëntë*) Audit i brendshëm/Specialistë/Inspektorë (*nëpunës civilë të kategorisë ekzekutive*).

Me vendimin nr. 26, datë 04.06.2012, “Për një ndryshim në vendimin e Këshillit të Qarkut nr. 8, datë 29.12.2011, “Për miratimin e strukturës organike të administratës së Këshillit të Qarkut Tiranë”, struktura e Këshillit të Qarkut Tiranë shkurtohet me 1 punonjës, konkretisht pozicioni i Auditi të Brendshëm suprimohet, për rrjedhojë punonjësja *****”, pas ristrukturimit me vendimin nr. 32 (nr. 1678 prot.), datë 19.06.2012 emërohet në pozicionin *Specialiste Ekonomie*, pranë Sektorit të Infrastrukturës dhe Transportit. Në këtë moment në këtë strukturë ekzistojnë edhe 3 (tre) vende vakante.

1/b Gjëndja e strukturës organizativetë Këshillit të Qarkut Tiranë pas procesit të ristrukturimit.

Sipas Vendimit nr. 216, datë 22.12.2014, “Për miratimin e strukturës organike të Administratës së Këshillit të Qarkut Tiranë”, që është në fuqi në momentin e kryerjes së mbikëqyrjes, rezulton se administrata e Këshillit të Qarkut Tiranë ka gjithsej **34** pozicione pune, nga të cilët **22** pozicione pune në shërbimin civil dhe ka ndryshime të strukturës në krahasim me atë të mëparshme.

Konkretisht, struktura është e riorganizuar si më poshtë:

- I. Sekretar i Përgjithshëm
- II. Drejtorja e Financës, Çështjeve Ligjore dhe Administratësme organikë **1**(një) drejtor, **1** (një) përgjegjës sektori dhe **6**(gjashtë) specialistë;
- III. Drejtorja e Planifikimit Urban, Mjedisit, Transportit, Infrastrukturës dhe Zhvillimit Rajonalme organikë **1**(një) drejtor, **1**(një)përgjegjës sektori dhe **4**(katër) specialistë;
- IV. Drejtorja e Administrimit dhe Mbrojtjes së Tokësme organikë**1**(një) drejtor, **1**(një) përgjegjës sektori dhe **3** (tre) specialistë.
- V. Inspektoriati i Mbrojtjes së Tokësme organikë**1**(një) kryeinspektor dhe **1** (një) inspektor.

Sa më sipër rezulton se me miratimin e strukturës së re me Vendimin nr. 216, datë 22.12.2014, “Për miratimin e strukturës organike të Administratës së Këshillit të Qarkut Tiranë”, në këtë institucion janë **22 pozicione pune** pjesë e shërbimit civil, sipas klasifikimit të mëposhtëm:

- 1 pozicion “*Sekretari i Përgjithshëm*”(nëpunës civil i nivelit të lartë drejtues);
- 3 pozicione “*Drejtor Drejtorie*”(nëpunës civilë të nivelit të mesëm drejtues);
- 4 pozicione “*Përgjegjës sektori/ Kryeinspektor*”(nëpunës civilë të nivelit të ulët drejtues);
- 14 pozicione “*Specialist/Inspektor*”(nëpunës civilë të nivelit ekzekutiv).

Nga krahasimi i strukturave arrihen në konkluzionin se institucioni, Këshilli i Qarkut Tiranë ka kaluar një proces të plotë ristrukturimi, pasi konstatohet ekzistenca e dy kërkesave ligjore: shkurtimi i numrit të përgjithshëm të nëpunësve civilë nga **54** në **34** punonjës dhe ndryshimi i strukturës organizative.

► **Respektimi i kërkesave ligjore të nenit 50 të ligjit 152/2013, “Për nëpunësin civil”, të ndryshuar.**

Këshilli i Qarkut Tiranë në funksion të procesit të ristrukturimit dhe në zbatim të Vendimit nr. 216, datë 22.12.2014, “Për miratimin e strukturës organike të Administratës së Këshillit të Qarkut Tiranë”, me vendimin nr. 218, datë 22.12.2014, ka miratuar “Rregulloren e Funksionimit të Brendshëm të Administratës së Këshillit të Qarkut të Tiranë”.

Rregullorja është e bazuar në ligjin nr. 8652, datë 31.07.2000, “Për organizimin dhe funksionimin e qeverisjes vendore”; ligjin nr.152/2013, “Për nëpunësin civil”, i ndryshuar; ligji nr. 8485, datë 12.05.1999, Kodi i Procedurave Administrative të Republikës së Shqipërisë; ligji nr. 9131, datë 08.09.2003, “Për rregullat e etikës në administratën publike”. Kjo rregullore ka përcaktuar misionin e Këshillit të Qarkut Tiranë dhe ka përcaktuar mënyrën dhe procedurën e vlerësimit të pozicioneve të punës të mbetura në kushtet aktuale në përputhje me detyrat e përgjegjësitë e reja; detyrat funksionale të sektorëve dhe nëpunësve të tyre.

Komisioneri për Mbikëqyrjen e Shërbimit Civil konstaton se në tërësi, i gjithë procesi i ristrukturimit është kryer në përputhje me ligjin. Vendimet e lirimimit si dhe rrimërimimit të nëpunësve civilë aktualë janë hartuar në përputhje me nenin 50 të ligjit nr. 152/2013, “Për nëpunësin civil”, i ndryshuar; Vendimin nr.171, datë 26.03.2014, “Për transferimin e përhershëm dhe të përkohshëm të nëpunësve civilë, pezullimin dhe lirimimin nga shërbimi civil” të Këshillit të Ministrave dhe Vendimin nr.142, datë 12.03.2014, “Për përshkrimin dhe klasifikimin e pozicioneve të punës në institucionet e administratës shtetërore dhe institucionet e pavarura” të Këshillit të Ministrave, më konkretisht të detajuara në anekset bashkëlidhur këtij raporti.

• **Aktet e emërimit të punonjësve të Këshillit të Qarkut Tiranë pas ristrukturimit (në mënyrë të detajuar janë të pasqyruara në Aneksin 4-historiku):**

1. ***** - me aktin administrativ nr. 22, datë 05.01.2015 të titullarit ripozicionohet në pozicionin e Sekretarit të Përgjithshëm (nëpunës civil i nivelit të lartë drejtues). Ka filluar punë me Urdhrin e Brendshëm të Titullarit nr. 27, datë 19.06.2012, “Për emërimin e ***** në detyrën e Sekretarit të Përgjithshëm të Këshillit të Qarkut Tiranë” (pa procedurë konkurimi). Akti i Deklarimit të Statusit të punësimit nr. 683 datë 13.06.2014, “nëpunës civil”.
2. ***** - me aktin administrativ nr. 3 prot., datë 05.01.2015, të Sekretarit të Përgjithshëm, ripozicionohet në pozicionin Drejtor në Drejtorinë e Financës, Çështjeve Ligjore dhe Administratës (nëpunës civil i nivelit të mesëm drejtues, kategoria II-b). Para ristrukturimit nëpunësja ka qenë në të njëjtin pozicion pune; është emëruar në shërbimin civil me aktin nr. 2785, datë 03.07.2008 (rekrutuar sipas procedurave të rekrutimit në

shërbimin civil, në zbatim të ligjit nr. 8459, datë 11.11.1999, “*Statusi i nëpunësit civil*”. Akti i Deklarimit të Statusit nr. 465 prot., datë 16.04.2014 “nëpunës civil”.

3. ***** - me aktin administrativ nr. 4 prot., datë 05.01.2015 ripozicionohet në pozicionin *Specialist për Administrimin Financiar në Drejtorinë e Financës Çështjeve Ligjore dhe Administratës (nëpunës civil i nivelit ekzekutiv, kategoria IV-a)*. Para ristrukturimit nëpunësja ka qenë në të njëjtin pozicion pune; është emëruar në shërbimin civil me aktin nr. 2787 datë 07.03.2008 (rekrutuar sipas procedurave të rekrutimit nëshërbimin civil në zbatim të ligjit nr. 8459, datë 11.11.1999, “*Statusi i nëpunësit civil*”). Akti i Deklarimit të Statusit nr. 465/1 prot., datë 16.04.2014 “nëpunës civil”.
4. ***** - si rezultat i suprimimit të vendit të punës, me vendim nr. 15 (nr. 174prot.) datë 16.01.2015, kalon në pozicionin *Specialist Prokurimi në Drejtorinë e Financës Çështjeve Ligjore dhe Administratës (nëpunës civil i nivelit ekzekutiv, kategoria IV-a)*. Para ristrukturimit nëpunësja ka qenë në të njëjtin nivel por në një pozicion tjetër pune, Specialist i Nivelit të Lartë për Buxhetin dhe Burimet Financiare në Departamentin e Burimeve Njerëzore dhe Shërbimeve (emëruar me Vendim të Titullarit, nr. 1 (nr. 269/1 prot.) datë 01.02.2011). Marrëdhëniet e punës në Këshillin e Qarkut Tiranë ka filluar që në vitin 2008. Akti i Deklarimit të Statusit të punësimit nr. 465/2 prot., datë 16.04.2014 “nëpunës civil” (rekrutuar sipas procedurave të rekrutimit në shërbimin civil në zbatim të ligjit nr. 8459, datë 11.11.1999, “*Statusi i nëpunësit civil*”).
5. ***** - me aktin administrativ nr. 4 (nr. 20prot.), datë 05.01.2015 ripozicionohet në pozicionin *Përgjegjës në Sektorin Juridik dhe Administratës në Drejtorinë e Financës, Çështjeve Ligjore dhe Administratës (nëpunës civil i nivelit të ulët drejtues, kategoria III–a/1)*. Para ristrukturimit nëpunësja ka qenë nëpunës civil e nivelit ekzekutiv, (akt emërimi nr. 623, datë 26.02.2002). Akti i Deklarimit të Statusit nr. 465/1 prot., datë 16.04.2014 “nëpunës civil”. Emëruar në pozicionin aktual “*Përgjegjës në Sektorin e Çështjeve Ligjore, Drejtoria e Çështjeve Ligjore dhe Personelit*” sipas procedurës së ngritjes në detyrë me akt-emërimi nr. 48 (nr. 1502 prot.) datë 20.11.2014. (rekrutuar sipas procedurave të rekrutimit në shërbimin civil në zbatim të ligjit nr. 152/2013, “*Për nëpunësin civil*”, i ndryshuar).
6. ***** - me aktin administrativ nr. 7(nr.24prot.), datë 05.01.2015 ripozicionohet në pozicionin *Specialist për Çështjet Administrative në Drejtorinë e Financës Çështjeve Ligjore dhe Administratës(nëpunës civil i nivelit ekzekutiv, kategoria IV-a)*.Para ristrukturimit nëpunësja ka qenë në të njëjtën pozicion pune, është emëruar në shërbimin civil me aktin 23 (nr. 1210 prot.) datë 14.05.2013(rekrutuar sipas procedurave të rekrutimit në shërbimin civil në zbatim të ligjit nr. 8459, datë 11.11.1999, “*Statusi i nëpunësit civil*”).Akti i Deklarimit të Statusit nr. 386 prot., datë 20.03.2014 “nëpunës civil”).Marrëdhëniet e punës në Këshillin e Qarkut Tiranë ka filluar në28.03.2008, në të njëjtin nivel.
7. ***** - me aktin administrativ nr. 9 (nr. 28 prot.),datë 05.01.2015, ripozicionohet në pozicionin *Specialist të Burimeve Njerëzore në Drejtorinë e Financës Çështjeve Ligjore dhe Administratës (nëpunës civil i nivelit ekzekutiv, kategoria IV-a)*, Para

ristrukturimit nëpunësja ka qenë nëpunës civil i nivelit të mesëm drejtues në pozicionin *Drejtor i Drejtorisë së Shërbimeve, Çështjeve Ligjore dhe Personelit* (akt emërimi nr. 1480 prot., datë 13.04.2008). Akti i Deklarimit të Statusit të punësimit me shkresën nr 386, datë 20.03.2014 “nëpunës civil”. Pozicioni i pranuar nga vetë nëpunësja (rekrutuar sipas procedurave të rekrutimit në shërbimin civil në zbatim të ligjit nr. 8459, datë 11.11.1999, “*Statusi i nëpunësit civil*”).

8. ***** - me aktin administrativ nr. 8, datë 05.01.2015, ripozicionohet në pozicionin *Specialist i Kulturës në Drejtorinë e Financës Çështjeve Ligjore dhe Administratës* (nëpunës civil i nivelit ekzekutiv, kategoria IV-a). Para ristrukturimit nëpunësi ka qenë në të njëjtin nivel, por në pozicion tjetër pune. Është emëruar në shërbimin civil me aktin nr. 623 prot., datë 26.04. 2002, në pozicionin *Specialist për Politikën Kulturore dhe Turizmin* (rekrutuar sipas procedurave të rekrutimit në shërbimin civil në zbatim të ligjit nr. 8459, datë 11.11.1999, “*Statusi i nëpunësit civil*”). Akti i Deklarimit të Statusit të punësimit nr. 679/2 prot., datë 13.06.2014 “nëpunës civil”.
9. ***** - me aktin administrativ nr. 2, (nr. 14 prot.), datë 05.01.2015, ripozicionohet në pozicionin *Specialist për Marrëdhëniet me Publikun në Drejtorinë e Financës dhe Çështjeve Ligjore dhe Administratës* (nëpunës civil i nivelit ekzekutiv, kategoria IV-a). Para ristrukturimit nëpunësi ka qenë në të njëjtin nivel, por në pozicion tjetër pune. Emëruar në shërbimin civil me aktin nr. 9 (nr. 187 prot.), datë 31.01.2014. Akti i Deklarimit të Statusit nr. 682/4, datë 13.06.2014 “nëpunës civil në periudhë prove” në pozicionin *Specialist për Marrëdhëniet me Publikun në Drejtorinë e Shërbimeve dhe Çështjeve Ligjore dhe Personelit*.
10. ***** - me aktin administrativ nr. 14 (nr. 38 prot.) datë 05.01.2015, ripozicionohet në pozicionin *Drejtor në Drejtorinë e Planifikimit Urban, Mjedisit, Transportit, Infrastrukturës dhe Zhvillimit Rajonal*, (nëpunës civil i nivelit të mesëm drejtues, kategoria II-b). Ka filluar marrëdhëniet e punës në institucion në vitin 1996. Konfirmohet si nëpunës civil ekzistues në zbatim të nenit 27, Kreu X, "Dispozita Kalimtare", ligji nr. 8549, datë 11.11.1999 “*Statusi i Nëpunësit Civil*”, me vendimin nr. 2, (nr. 279 prot.) datë 01.03.2002, në pozicionin *Përgjegjës i Sektorit Urbanistik*. Me strukturën emiratuar me vendimin nr. 70, datë 10.12.2007, “Për miratimin e strukturës organike të Këshillit të Qarkut Tiranë” është emëruar në pozicionin *Drejtor i Departamentit të Planifikimit Urban dhe Kontrollit mbi Territorin* (vendim i Sek. Pergj). Akti i Deklarimit të Statusit të punësimit me shkresën nr. 513 prot., datë 29.04.2014 “nëpunës civil”, në pozicionin *Drejtor i Drejtorisë së Planifikimit Urban, Infrastrukturës dhe Transportit*.
11. ***** - me aktin administrativ nr. 15 (nr. 40 prot.) datë 05.01.2015, ripozicionohet në pozicionin *Specialist për Arkivin dhe Kadastrën Urbane në Drejtorinë e Planifikimit Urban, Transportit, Infrastrukturës dhe Zhvillimit Rajonal*, (nëpunës civil i nivelit ekzekutiv, kategoria IV-a). Para ristrukturimit ka qenë në pozicionin *Specialist i Kadastrës Urbane në Drejtorinë e Planifikimit Urban Infrastrukturës dhe Transportit*, sistemuar me shkresën nr. 22 (nr. 598 prot.) datë 21.02.2012. Ka filluar marrëdhëniet e punës në institucion me vendimin e titullarit nr. 10 (nr. 11/3 prot.) datë 21.02.2001, (rekrutuar sipas procedurave të rekrutimit në shërbimin civil në zbatim të ligjit nr. 8459,

datë 11.11.1999, “*Statusi i nëpunësit civil*”). Akti i Deklarimit të Statusit nr. 513/2 prot., datë 29.04.2014 “nëpunës civil”.

12. ***** - me aktin administrativ nr. 16 (nr. 42 prot.) datë 05.01.2015, ripozicionohet në pozicionin *Specialist për Mjedisin dhe Turizmin në Drejtorinë e Planifikimit Urban Transportit, Infrastrukturës dhe Zhvillimit Rajonal (nëpunës civil i nivelit ekzekutiv, kategoria IV–a)*. Para ristrukturimi ka qenë në pozicionin *Specialist i Bujqësisë dhe Mjedisit në Sektorin e Marrëdhënieve me Bashkitë dhe Komunat në Drejtorinë e Zhvillimit Rajonal*, sistemuar me vendimin nr. 12 (nr. 588 prot.) datë 21.02.2012. Marrëdhëniet punës në institucion i ka filluar në datë 03.07.2008 (rekrutuar sipas procedurave të rekrutimit në shërbimin civil në zbatim të ligjit nr. 8459, datë 11.11.1999, “*Statusi i nëpunësit civil*”). Akti i Deklarimit të Statusit nr. 680/1 prot., datë 13.06.2014 “nëpunës civil”.
13. ***** - me aktin administrativ nr. 17 (nr. 44 prot.) datë 05.01.2015, ripozicionohet në pozicionin *Përgjegjës i Sektorit për Transportin, Infrastrukturën dhe Zhvillimin Rajonal në Drejtorinë e Planifikimit Urban Transportit, Infrastrukturës dhe Zhvillimit Rajonal (nëpunës civil i nivelit të ulët drejtues, kategoria III–a/1)*. Emëruar si nëpunës civil me shkresën nr. 5671 prot., datë 31.12.2008, në pozicionin *Drejtor në Drejtorinë e Projekteve të Infrastrukturës*. Më pas është sistemuar në pozicionin *Përgjegjës i Sektorit të Infrastrukturës dhe Transportit në Drejtorinë e Planifikimit Urban, Infrastrukturës dhe Transportit*, me vendimin nr. 19 (nr. 595 prot.), datë 21.02.2012. (rekrutuar sipas procedurave të rekrutimit në shërbimin civil në zbatim të ligjit nr. 8459, datë 11.11.1999, “*Statusi i nëpunësit civil*”). Akti i Deklarimit të Statusit nr. 586 prot., datë 19.05.2014 “nëpunës civil”.
14. ***** - me aktin administrativ nr. 19 (nr. 48 prot.) datë 05.01.2015, dhe deklaratën e saj, sistemohet në pozicionin *Specialist për Zhvillimin Rajonal në Drejtorinë e Planifikimit Urban Transportit, Infrastrukturës dhe Zhvillimit Rajonal (nëpunës civil i nivelit ekzekutiv, kategoria IV–a)*. Para ristrukturimit ka qenë në pozicionin *Drejtor i Drejtorisë së Zhvillimit Rajonal*, akti i emërimit për ngritje në detyrë me vendimin nr. 2 (nr. 158 prot.) datë 27.01.2014. Ka filluar marrëdhëniet e punës dhe ato financiare në institucion me vendimin e titullarit nr. 16 (nr. 11/10 prot.) datë 01.03.2001, në pozicionin *Specialist në Seksionin e Programimit dhe Zhvillimit Rajonal* (rekrutuar sipas procedurave të rekrutimit në shërbimin civil në zbatim të ligjit nr. 8459, datë 11.11.1999, “*Statusi i nëpunësit civil*”). Akti i Deklarimit të Statusit nr. 679 prot., datë 13.06.2014 “nëpunës civil në periudhë prove” në pozicionin *Drejtor i Drejtorisë së Zhvillimit Rajonal*.
15. ***** - me aktin administrativ nr. 18 (nr. 46 prot.), datë 05.01.2015, sistemohet në pozicionin *Specialist për Marrëdhëniet me Njësitë Vendore dhe Zgjedhjet në Drejtorinë e Planifikimit Urban, Mjedisit, Transportit, Infrastrukturës dhe Zhvillimit Rajonal (nëpunës civil i nivelit ekzekutiv, kategoria IV–b)*. Para sistemimit ka qenë në pozicionin *Përgjegjës i Sektorit të Marrëdhënieve me Bashkitë dhe Komunat në Drejtorinë e Zhvillimit Rajonal* emëruar me Urdhrin e Brendshëm të Titullarit nr. 16 (nr. 226 prot.), datë 10.02.2014 (pa procedura rekrutimi). Akti i Deklarimit të Statusit të punësimit është në periudhë pritje

sipas realacionit nr. 682/6 prot., datë 11.08.2014, “*Relacion mbi verifikimin e procedurës së rekrutimit dhe deklarimit të punësimit aktual të ******”.

- ***Drejtorja e Administrimit dhe Mbrojtjes së Tokës, nuk ka ndryshime as në numër punonjësish dhe as në emërtese.***
16. ***** - me aktin administrativ nr. 1 (nr. 157 prot.), datë 27.01.2014, emërohet si “nëpunës civil në periudhë prove” në pozicionin *Drejtor i Drejtorisë së Administrimit dhe Mbrojtjes së Tokës (nëpunës civil i nivelit të mesëm drejtues, kategoria II-b)*. Fillimisht marrëdhëniet e punës dhe marrëdhëniet financiare në institucion kanë filluar me Urdhërin e Brendshëm të Titullarit nr. 8 (nr. 275 prot.), datë 06.02.2013, me kontratë të përkohshme në kushte emergjente deri në përfundim të procedurave të konkurimit (kontratë me nr. 275/1 prot., datë 06.02.2013) në pozicionin inspektor në Inspektoriatin e Mbrojtjes së Tokës. Më pas emërohet si “nëpunës civil në periudhë prove” me aktin nr. 1 (nr. 157 prot.), datë 27.01.2014 (rekrutuar sipas procedurave të rekrutimit në shërbimin civil në zbatim të ligjit nr. 8459, datë 11.11.1999, “*Statusi i nëpunësit civil*”). Akti i Deklarimit të Statusit të punësimit nr. 586 prot., datë 19.05.2014 “nëpunës civil në periudhë prove”.
 17. ***** - Ka filluar marrëdhëniet e punës dhe marrëdhëniet financiare në institucion me shkresën nr. 569/2 prot., datë 01.03.2006 dhe është emëruar si “nëpunës civil në periudhë prove” në pozicionin *Inspektor në Inspektoriatin e Mbrojtjes së Tokës*. Është konfirmuar me shkresën e titullarit nr. 424/1 prot., datë 02.03.2007 si “nëpunës civil” në pozicionin *Inspektor në Inspektoriatin e Mbrojtjes së Tokës në Seksionin e Administrimit dhe Mbrojtjes së Tokës*. Është emëruar me kontratë të përkohshme deri në përfundim të procedurave të konkurimit, në pozicionin *Përgjegjës në Drejtorinë e Administrimit dhe Mbrojtjes së Tokës* me Urdhër të Brendshëm nr. 7 (nr. 216 prot.), datë 31.01.2013 (pa procedure rekrutimi si *nëpunës civil i nivelit të ulët drejtues, kategoria III-b*). (Rekrutuar sipas procedurave të rekrutimit në shërbimin civil në zbatim të ligjit nr. 8459, datë 11.11.1999 “*Statusi i nëpunësit civil*”, vetëm në pozicionin *Inspektor*). Akti i Deklarimit të Statusit nr. 681/2, datë 13.06.2014 “nëpunës civil”.
 18. ***** - Emëruar me vendim të titullarit nr. 7 (nr. 176 prot.), datë 30.01.2014 “nëpunës civil në periudhë prove” në pozicionin *Specialist për Arshivën në Drejtorinë e Administrimit dhe Mbrojtjes së Tokës (nëpunës civil i nivelit ekzekutiv, kategoria IV-b)*. Ka filluar marrëdhëniet e punës dhe marrëdhëniet financiare në institucion me Urdhërin e Brendshëm të Titullarit nr. 24 (nr. 1633 prot.), datë 14.06.2012, me kontratë të përkohshme deri në përfundim të procedurave të konkurrimit (kontratë me nr. 1633/2 prot., datë 14.06.2012) në pozicionin *Specialist në Inspektoriatin e Mbrojtjes së Tokës*. Rekrutuar sipas procedurave të rekrutimit në shërbimin civil në zbatim të ligjit nr. 8459, datë 11.11.1999, “*Statusi i nëpunësit civil*”. Akti i Deklarimit të Statusit nr. 681/2, datë 13.06.2014 “nëpunës civil”.
 19. ***** - Ka filluar marrëdhëniet e punës dhe marrëdhëniet financiare në institucion sipas regjistrimit themeltar në datën 16.02.1996 në pozicionin *Specialist Kadastre*. Konfirmohet si nëpunës civil ekzistues në zbatim të nenit 27, Kreu X, "Dispozita

Kalimtare", ligji nr. 8549, datë 11.11.1999, "*Statusi i Nëpunësit Civil*" me shkresën nr. 26 prot., datë 20.04.2004 në pozicionin *Specialist për Arshivën Kavajë në Drejtorinë e Administrimit dhe Mbrojtjes së Tokës (nëpunës civil i nivelit ekzekutiv, kategoria IV–b)*. Akti i Deklarimit të Statusit nr. 681/4 prot., datë 13.06.2014 "nëpunës civil".

20. ***** - Emëruar me vendim të titullarit "nëpunës civil në periudhë prove" me shkresën nr. 3065 prot., datë 02.09.2009, në pozicionin *Specialist për Azhornimin Topografik e Kadastral të Tokës në Drejtorinë e Administrimit dhe Mbrojtjes së Tokës (nëpunës civil i nivelit ekzekutiv, kategoria IV–b)*. Rekrutuar sipas procedurave të rekrutimit në shërbimin civil në zbatim të ligjit nr. 8459, datë 11.11.1999 "*Statusi i nëpunësit civil*". Akti i Deklarimit të Statusit nr. 681/3 prot., datë 13.06.2014 "nëpunës civil".
21. ***** - Me strukturën e re nuk ka ndryshim emërtese, por riemërim me shkresën nr. 20 (nr. 50 prot.) datë 05.01.2015, në të njëjtin pozicion *Kryeinspektor i Mbrojtjes së Tokës në Inspektoriatin e Mbrojtjes së Tokës (nëpunës civil i nivelit të ulët drejtues, kategoria III–b)*. Ka filluar marrëdhëniet e punës dhe marrëdhëniet financiare në institucion me aktin e emërimit të titullarit nr. 2 (nr. 569/1 prot.), datë 01.03.2006, "nëpunës civil në periudhë prove" në pozicionin *Kryeinspektor në Inspektoriatin e Mbrojtjes së Tokës*. Konfirmuar me vendim të titullarit si "nëpunës civil" nr. 424 prot., datë 02.03.2007 në pozicionin *Kryeinspektor në Inspektoriatin e Mbrojtjes së Tokës*. Rekrutuar sipas procedurave të rekrutimit në shërbimin civil në zbatim të ligjit nr. 8459, datë 11.11.1999, "*Statusi i nëpunësit civil*". Akti i Deklarimit të Statusit nr. 681/6 prot., datë 13.06.2014 "nëpunës civil".
22. ***** - Me strukturën e re nuk ka ndryshim emërtese, por riemërim me shkresën nr. 21 (nr. 52 prot.), datë 05.01.2015 në të njëjtin pozicion *Inspektor në Inspektoriatin e Mbrojtjes së Tokës, (nëpunës civil i nivelit ekzekutiv, kategoria IV–b)*. Ka filluar marrëdhëniet e punës dhe marrëdhëniet financiare në institucion me Urdhrin e Brendshëm të Titullarit nr. 37 (nr. 2287 prot.), datë 06.11.2013, me kontratë të përkohshme në kushte emergjente deri në përfundim të procedurave të konkurrimit (kontratë me nr. 2306/1 prot., datë 07.11.2013 por fillon në datë 06.11.2013) në pozicionin *Inspektor në Inspektoriatin e Mbrojtjes së Tokës*. Me vendim emërimi të titullarit me shkresën nr. 8 (nr. 177 prot.), datë 30.01.2014, është emëruar "nëpunës civil në periudhë prove" në pozicionin *Inspektor në Inspektoriatin e Mbrojtjes së Tokës*. Rekrutuar sipas procedurave të rekrutimit në shërbimin civil në zbatim të ligjit nr. 8459, datë 11.11.1999, "*Statusi i nëpunësit civil*". Akti i Deklarimit të Statusit nr. 681/3 prot., datë 13.06.2014 "nëpunës civil".

► ***Procedura ligjore e ndjekur nga njësia përgjegjëse e burimeve njerëzore në marrjen e vendimit përfundimtar të lirimt nga shërbimi civil i nëpunësve të cilëve është shkurtuar pozicioni i punës për shkak të ristrukturimit të institucionit, komenti ligjor dhe konkluzionet për secilin rast***

Komisioni i Ristrukturimit është krijuar me Urdhrin nr. 2 (nr. 10 prot.), datë 05.01.2015, të Sekretarit të Përgjithshëm të Këshillit të Qarkut Tiranë "*Për ngritjen dhe përbërjen e Komisionit*

të Ristrukturimit”, dalë në bazë e për zbatim të Vendimit nr. 216, datë 22.12.2014, “Për miratimin e strukturës organike të Administratës së Këshillit të Qarkut Tiranë”, nenit 50 të ligjit 152/2013, “Për nëpunësin civil” i ndryshuar, Vendimit nr.171, dt.26.03.2014 “Për transferimin e përhershëm dhe të përkohshëm të nëpunësve civilë, pezullimin dhe lirin nga shërbimi civil” të Këshillit të Ministrave dhe Vendimit nr.142, datë 12.03.2014, “Për përshkrimin dhe klasifikimin e pozicioneve të punës në institucionet e administratës shtetërore dhe institucionet e pavarura” të Këshillit të Ministrave dhe Udhëzimit nr.3, datë 14.04.2014, “Për krijimin, funksionimin dhe kompetencat e komisionit të ristrukturimit për shkak të mbylljes apo ristrukturimit” të Departamentit të Administratës Publike.

Komisioni i ristrukturimit pasi ka përmbushur detyrimet ligjore të përcaktuara në pikën 3 të nenit 50 të ligjit nr. 152/2013, “Për nëpunësin civil” i ndryshuar, Vendimin nr.171, datë 26.03.2014, “Për transferimin e përhershëm dhe të përkohshëm të nëpunësve civilë, pezullimin dhe lirin nga shërbimi civil” të Këshillit të Ministrave, ka bërë propozimet përkatëse, para njësisë së personelit për sistemimin në punë dhe riemërim të punonjësve që plotësojnë kriteret.

Për këtë është mbajtur si kriter thelbësor fakti që, gjithë kompetencat dhe funksionet e Këshillit të Qarkut (të cilat janë të pandryshuara, pasi nuk kemi ndryshime të qëllimit, funksionit apo kompetencave të institucionit) do të plotësohen me një numër më të pakët punonjësish. Kjo situatë ka diktuar shkrirjen e drejtorive, uljen e nivelit dhe kategorive të pozicioneve të punës dhe bashkimin e disa funksioneve të mëparshme në një pozicion pune.

Kjo ka ndikuar në konkluzionin e Komisionit të Ristrukturimit, që pas kryerjes së këtij veprimi administrativ ka propozuar qëndrimin dhe riemërimin e punonjësit më të kualifikuar dhe më me eksperiencë, në mënyrë që të ishin të aftë të përshtateshin me kërkesat individuale të reja të punëve, ku një nëpunës i vetëm duhej të përballonte me shumë ngarkesëpunën e disa nëpunësve, sipas strukturës së mëparshme si dhe me cilësitë personale dhe eksperiencën e secilit punonjës.

Gjithë procedura e ndjekur më sipër është konkluduar me vendime të Komisionit të Ristrukturimit, për secilin punonjës, i cili ka vendosur lirin nga detyra të atyre nëpunësve civilë të cilëve, për shkak të ristrukturimit të institucionit, ose u është shkurtuar pozicioni i punës, ose u është riformatuar, bashkuar apo fuzionuar, me pozicione të tjera.

Nisur nga sa më sipër, njësia e personelit ka pranuar propozimet e Komisionit të Ristrukturimit dhe ka nxjerrë aktet e riemërimin të nëpunësve civilëpas ristrukturimit. Nga ana e grupit të inspektimit u konstatua se në rastin kur ka pasur ulje në detyrë të punonjësit, është marrë mendimi i tij me shkrim për pranimin ose refuzimin e pozicionit të ofruar siç përcaktohet në pikën 19 dhe 20, Kreu III “Transferimi për shkak të mbylljes dhe ristrukturimit të institucionit” të Vendimit nr.171, datë 26.03.2014 , “Për transferimin e përhershëm dhe të përkohshëm të nëpunësve civilë, pezullimin dhe lirin nga shërbimi civil”, i cili i plotëson kërkesat e nenit 50 të ligjit nr. 152/2013 “Për nëpunësin civil”, i ndryshuar, vendimit nr. 171, datë 26.03.2014, “Për transferimin e përhershëm dhe të përkohshëm të nëpunësve civilë, pezullimin dhe lirin nga shërbimi civil”, të Këshillit të Ministrave, Kreu III, “Transferimi për shkak të mbylljes dhe ristrukturimit të institucionit” dhe vendimit nr.142, datë 12.03.2014, “Për përshkrimin dhe klasifikimin e pozicioneve të punës në institucionet e administratës shtetërore dhe institucionet e pavarura” të Këshillit të Ministrave.

• **Paskryerjes së ristrukturimit, u liruan punonjësit e mëposhtëm:**

1. ***** – nëpunës civil i nivelit të lartë drejtues me detyrë “*Drejtor i Përgjithshëm*” (kategoria II-a). Ka filluar punë pranë Këshillit të Qarkut Tiranë me urdhrin e titullarit nr. 1, datë 03.01.2011 në pozicionin *Specialist për Arsimin në Drejtorinë e Zhvillimit Rajonal*. Në dhjetor të 2013 është konfirmuar si nëpunës civil i nivelit të lartë drejtues në pozicionin “*Drejtor i Përgjithshëm*”. Aktin e Deklarimit të statusit të punësimit si nëpunës civil në periudhë prove me nr. 682, datë 13.06.2014 e ka në të njëjtin pozicion. Me Vendimin nr. 17 (nr. 176 prot.) datë 16.01.2015 është liruar nga shërbimi civil për shkak të dorëheqjes. Gjithashtu, pozicioni i *Drejtorit të Përgjithshëm* me strukturën e re të miratuar me Vendimin nr. 216, datë 22.12.2014 “*Për miratimin e strukturës organike së Administratës së Këshillit të Qarkut Tiranë*” **nuk ekziston më**.
2. ***** – nëpunës civil i nivelit ekzekutiv me detyrë “*Specialist për prokurimet publike në Sektorin e Shërbimeve dhe Personelit në Drejtorinë e Shërbimeve, Çështjeve Ligjore dhe Personelit*” (kategoria IV-a). Ka filluar punë pranë Këshillit të Qarkut Tiranë me urdhrin e titullarit nr. 29, datë 02.12.2011 në pozicionin “*Specialist për Prokurimet në Drejtorinë e Shërbimit të Çështjeve Ligjore dhe Personelit*”, Aktin e Deklarimit të statusit të punësimit si nëpunës civil në periudhë proveme nr. 682/2, datë 13.06.2014 e ka në të njëjtin pozicionin. Me Vendimin nr. 1 (nr. 134prot.) datë 15.01.2015, është liruar nga shërbimi civil për shkak të dorëheqjes. Pozicioni i specialistit për prokurimet publike me strukturën e re të miratuar me Vendimin nr. 216, datë 22.12.2014 “*Për miratimin e strukturës organike së Administratës së Këshillit të Qarkut Tiranë*” ekziston. Komisioni i Ristrukturimit duke e vlerësuar kriterine vjetersisë në punë si kryesor, ka konsideruar që në këtë pozicion të mbetet një punonjës ekzistues që ka një vjetërsi pune më të madhe, konkretisht punonjësja ***** me vjetërsi në punë prej 12 vjetësh.
3. ***** – nëpunës civil i nivelit ekzekutiv me detyrë “*Specialist i Infrastrukturës në Sektorin e Infrastrukturës dhe Transportit në Drejtorinë e Planifikimit Urban, Iinfrastrukturës dhe Transportit*” (kategoria IV-a). Ka filluar punë pranë Këshillit të Qarkut Tiranë me urdhrin e titullarit nr. 14, datë 27.04.2012 në pozicionin “*Specialist i Infrastrukturës në Sektorin e Infrastrukturës dhe Transportit në Drejtorinë e Planifikimit Urban, Infrastrukturës dhe Transportit*”. Aktin e Deklarimit të statusit të punësimit si nëpunës civil në periudhë prove me nr. 586/1, datë 19.05.2014 e ka në të njëjtin pozicion. Me njoftimin e Sekretarit të Përgjithshëm dhe Njesisë së Menaxhimit të Burimeve Njerëzore nr. 60 prot., datë 05.01.2015, është njoftuar që vendi i punës është suprimuar në bazë të Vendimin nr. 216, datë 22.12.2014 “*Për miratimin e strukturës organike së Administratës së Këshillit të Qarkut Tiranë*”. Ky pozicion me strukturën e re të miratuar me Vendimin nr. 216, datë 22.12.2014 **nuk ekziston më**. Gjithashtu, me shkresën nr. 137 prot., datë 15.01.2015 të Komisionit të Ristrukturimit është propozuar ndërprerja e marrëdhënieve të punës dhe me vendimin nr. 5 (prot. 164) datë 16.01.2015 është vendosur lirimi nga detyra dhe ndërprerja e marrëdhënieve të punës.

4. ***** – nëpunës civil i nivelit ekzekutiv me detyrë “*Specialist i urbanistikës në Sektorin e Planifikimit Urban në Drejtorinë e Planifikimit Urban, Infrastrukturës dhe Transportit*” (kategoria IV-a). Ka filluar punë pranë Këshillit të Qarkut Tiranë në vitin 1996. Konfirmohet si nëpunës civil ekzistues në zbatim të nenit 27, Kreu X, "Dispozita Kalimtare", ligji nr. 8549, datë 11.11.1999 “*Statusi i Nëpunësit Civil*”, me vendimin nr. 2, (nr. 279 prot.) datë 01.03.2002, në pozicionin *Përgjegjës i Sektorit Urbanistik*. Aktin e Deklarimit të Statusit të punësimit si nëpunës civil me nr. 513/1, datë 29.04.2014 e ka në pozicionin “*Specialist i Urbanistikës në Sektorin e Planifikimit Urban në Drejtorinë e Planifikimit Urban, I frastrukturës dhe Transportit*”. Me njoftimin e Sekretarit të Përgjithshëm dhe Njësisë së Menaxhimit të Burimeve Njerëzore nr. 56 prot., datë 05.01.2015, është njoftuar që vendi i punës është suprimuar në bazë të Vendimin nr. 216, datë 22.12.2014 “*Për miratimin e strukturës organike së Administratës së Këshillit të Qarkut Tiranë*”. Ky pozicion me strukturën e re të miratuar me Vendimin nr. 216, datë 22.12.2014 **nuk ekziston më**. Gjithashtu, me Relacionin nr. 148 prot., datë 15.01.2015 të Komisionit të Ristrukturimit është propozuar transferimi i tij në Komunën Farkë, në Drejtorinë e Zhvillimit dhe Kontrollit të Territorit. Konform shkresës së miratimit nga Komuna Farkë me nr. 137 prot., datë 15.01.2015 dhe deklaratës së miratimit të ***** në këtë pozicion, me vendimin nr. 16 (nr. 175 prot.) datë 16.01.2015 është vendosur lirimi nga detyra dhe ndërprerja e marrëdhënieve të punës dhe transferimi i tij në Komunën Farkë.
5. ***** – nëpunës civil i nivelit ekzekutiv me detyrë “*Specialist për Arsimin dhe Shëndetësinë në Sektorin e Marrëdhënieve për Bashkitë dhe Komunat në Drejtorinë e Zhvillimit Rajonal*” (kategoria III-b). Ka filluar punë pranë Këshillit të Qarkut Tiranë me urdhrin e titullarit nr. 31, datë 10.09.2013 në pozicionin “*Specialist për Arsimin dhe Shëndetësinë në Sektorin e Marrëdhënieve për Bashkitë dhe Komunat në Drejtorinë e Zhvillimit Rajonal*”. Aktin e Deklarimit të statusit të punësimit si nëpunës civil nëperiudhë prove me nr. 680/2, datë 13.06.2014 e ka në të njëjtin pozicion. Me shkresën nr. 143 prot., datë 15.01.2015 të Komisionit të Ristrukturimit është propozuar lirimi nga detyra dhe ndërprerja e marrëdhënieve të punës. Me vendimin nr. 11 (nr. 170 prot.) datë 16.01.2015 është vendosur lirimi nga detyra dhe ndërprerja e marrëdhënieve të punës si rezultat i ristrukturimit të institucionit në bazë të Vendimit nr. 216, datë 22.12.2014 “*Për miratimin e strukturës organike së Administratës së Këshillit të Qarkut Tiranë*”. Ky pozicion me strukturën e re të miratuar me Vendimin nr. 216, datë 22.12.2014 **nuk ekziston më**. Me urdhrin e Kryetarit nr. 7 (nr. 222 prot.) datë 22.01.2015 dhe me aprovimin e ***** me shkresën nr. 223/1 prot., datë 22.01.2015, është sistemuar në pozicionin sekretar i Kryetarit të Këshillit të Qarkut Tiranë. Pajisur me kontratë pa afat me nr. 223 prot., datë 22.01.2015 dhe efektet financiare fillojnë po në këtë datë.

6. ***** – nëpunës civil i nivelit ekzekutiv me detyrë “*Specialist për ekonominë në sektorin e Bashkëpunimit me Jashtë Drejtorinë e Planifikimit Urban, Infrastrukturës dhe Transportit*” (kategoria IV-a). Ka filluar punë pranë Këshillit të Qarkut Tiranë me urdhrin e titullarit nr. 3, datë 01.02.2013 në pozicionin “*Specialist për Ekonominë në Drejtorinë e Planifikimit Urban, Infrastrukturës dhe Transportit*”. Aktin e Deklarimit të statusit të punësimit si nëpunës civil në periudhë prove me nr. 586/2, datë 19.05.2014 e ka në të njëjtin pozicion. Me njoftimin e Sekretarit të Përgjithshëm dhe Njesisë së Menaxhimit të Burimeve Njerëzore me nr. 64 prot., datë 05.01.2015, është njoftuar që vendi i punës është suprimuar në bazë të Vendimin nr. 216, datë 22.12.2014 “*Për miratimin e strukturës organike së Administratës së Këshillit të Qarkut Tiranë*”. Ky pozicion me strukturën e re të miratuar me Vendimin nr. 216, datë 22.12.2014 **nuk ekziston më**. Gjithashtu, me shkresën nr. 138 prot., datë 15.01.2015 të Komisionit të Ristrukturimit është propozuar ndërprerja e marrëdhënieve të punës dhe me vendimin nr. 7 (nr. 166prot.) datë 16.01.2015 është vendosur lirimi nga detyra dhe ndërprerja e marrëdhënieve të punës.
7. ***** – nëpunës civil i nivelit ekzekutiv me detyrë “*Specialist për Arshivën në Sektorin e Planifikimit Urban në Drejtorinë e Planifikimit Urban, I frastrukturës dhe Transportit*”(kategoria IV-a). Ka filluar punë pranë Këshillit të Qarkut Tiranë me aktin nr. 30, datë 30.09.2004 në pozicionin “*Specialist në Drejtorinë e Urbanistikës*”. Aktin e Deklarimit të statusit të punësimit si nëpunës civil me nr. 513/3, datë 29.04.2014 e ka në të njëjtin pozicion. Me njoftimin e Sekretarit të Përgjithshëm dhe Njesisë së Menaxhimit të Burimeve Njerëzore nr. 58 prot., datë 05.01.2015, është njoftuar që vendi i punës është suprimuar në bazë të Vendimin nr. 216, datë 22.12.2014 “*Për miratimin e strukturës organike së Administratës së Këshillit të Qarkut Tiranë*”, sepse ky vend pune është bashkuar me kadastrën dhe është bërë specialist për arshivën dhe kadastrën urbane, pozicion në të cilën është mbajtur *****. Punonjësja ***** është vlerësuar të largohet për shkak se në datën 04.01.2015 ka mbushur moshën e daljes në pension. Gjithashtu, me shkresën nr. 136 prot., datë 15.01.2015 të Komisionit të Ristrukturimit është propozuar ndërprerja e marrëdhënieve të punës dhe me vendimin nr. 4 (nr. 163 prot.) datë 16.01.2015 është vendosur lirimi nga detyra dhe ndërprerja e marrëdhënieve të punës.
8. ***** – nëpunës civil i nivelit ekzekutiv me detyrë “*Specialist për Kontrollin e Projekteve në Sektorin e Planifikimit Urban në Drejtorinë e Planifikimit Urban, I frastrukturës dhe Transportit*” (kategoria IV-a). Ka filluar punë pranë Këshillit të Qarkut Tiranë në fillim me urdhrin e titullarit të datës 01.08.2003 në pozicionin “*Specialist për Kontrollin Teknik të Projekteve Ndërtimore*” dhe mëpas është konfirmuar me aktin nr. 426, datë 13.03.2007 në të njëjtin pozicion pune. Aktin e Deklarimit të statusit të punësimit si nëpunës civil me nr. 513/3, datë 29.04.2014 e ka në pozicionin “*Specialist i Kontrollit të Projekteve në Drejtorinë e Planifikimit Urban, I frastrukturës dhe Transportit*”. Me njoftimin e Sekretarit të Përgjithshëm dhe Njesisë së Menaxhimit

të Burimeve Njerëzore nr. 57 prot., datë 05.01.2015, është njoftuar që vendi i punës është suprimuar në bazë të Vendimin nr. 216, datë 22.12.2014 “Për miratimin e strukturës organike së Administratës së Këshillit të Qarkut Tiranë”. Ky pozicion me strukturën e re të miratuar me Vendimin nr. 216, datë 22.12.2014 **nuk ekziston më**. Gjithashtu, me shkresën nr. 135 prot., datë 15.01.2015 të Komisionit të Ristrukturimit është propozuar ndërprerja e marrëdhënieve të punës dhe me vendimin nr. 3 datë 16.01.2015 është vendosur lirimi nga detyra dhe ndërprerja e marrëdhënieve të punës.

9. ***** – nëpunës civil i nivelit ekzekutiv me detyrë “*Specialist për investimet e huaja në Sektorin e Bashkëpunimit me Jashtë në Drejtorinë Zhvillimit Rajonal*” (kategoria IV-a). Ka filluar punë pranë Këshillit të Qarkut Tiranë me urdhrin e titullarit nr. 6, datë 28.02.2012 në pozicionin “*Specialist për Investimet e Huaja në Sektorin e Bashkëpunimit me Jashtë në Drejtorinë Zhvillimit Rajonal*”. Aktin e Deklarimit të statusit të punësimit si nëpunës civil me nr. 679/4, datë 13.06.2014 e ka në të njëjtin pozicion. Me njoftimin e Sekretarit të Përgjithshëm dhe Njesisë së Menaxhimit të Burimeve Njerëzore nr. 61 prot., datë 05.01.2015, është njoftuar që vendi i punës është suprimuar në bazë të Vendimit nr. 216, datë 22.12.2014 “Për miratimin e strukturës organike së Administratës së Këshillit të Qarkut Tiranë”. Ky pozicion me strukturën e re të miratuar me Vendimin nr. 216, datë 22.12.2014 **nuk ekziston më**. Gjithashtu, me shkresën nr. 141 prot., datë 15.01.2015 të Komisionit të Ristrukturimit është propozuar ndërprerja e marrëdhënieve të punës dhe me vendimin nr. 12 (nr.171prot.,) datë 16.01.2015 është vendosur lirimi nga detyra dhe ndërprerja e marrëdhënieve të punës.
10. ***** – nëpunës civil i nivelit ekzekutiv me detyrë “*Specialist për projektet në Sektorin e Bashkëpunimit me Jashtë në Drejtorinë e Zhvillimit Rajonal*” (kategoria IV-a). Ka filluar punë pranë Këshillit të Qarkut Tiranë me aktin nr. 17, datë 23.09.2002 në pozicionin “*Specialist në Seksionin e Urbanistikës*”. Aktin e Deklarimit të statusit të punësimit si nëpunës civil me nr. 679/1, datë 13.06.2014 e ka në të njëjtin pozicion. Me njoftimin e Sekretarit të Përgjithshëm dhe Njesisë së Menaxhimit të Burimeve Njerëzore nr. 62 prot., datë 05.01.2015, është njoftuar që vendi i punës është suprimuar në bazë të Vendimit nr. 216, datë 22.12.2014 “Për miratimin e strukturës organike së Administratës së Këshillit të Qarkut Tiranë”. Ky pozicion me strukturën e re të miratuar me Vendimin nr. 216, datë 22.12.2014 **nuk ekziston më**. Gjithashtu, me shkresën nr. 140 prot., datë 15.01.2015 të Komisionit të Ristrukturimit është propozuar ndërprerja e marrëdhënieve të punës dhe me vendimin nr. 8 (nr. 167prot.,) datë 16.01.2015 është vendosur lirimi nga detyra dhe ndërprerja e marrëdhënieve të punës.
11. ***** – nëpunës civil i nivelit ekzekutiv me detyrë “*Specialist për marrëdhëniet me jashtë në Sektorin e Bashkëpunimit me Jashtë në Drejtorinë e Zhvillimit Rajonal*” (kategoria IV-a). Ka filluar punë pranë Këshillit të Qarkut Tiranë me urdhrin e titullarit

nr. 382/1, datë 08.04.2004 në pozicionin “*Specialist për Marrëdhëniet me Jashtë*”.Aktin e Deklarimit të statusit të punësimit si nëpunës civil me nr. 679/5, datë 13.06.2014 e ka në të njëjtin pozicion. Me njoftimin e Sekretarit të Përgjithshëm dhe Njesisë së Menaxhimit të Burimeve Njerëzore nr. 63 prot., datë 05.01.2015, është njoftuar që vendi i punës është suprimuar në bazë të Vendimit nr. 216, datë 22.12.2014 “*Për miratimin e strukturës organike së Administratës së Këshillit të Qarkut Tiranë*”.Ky pozicion me strukturën e re të miratuar me Vendimin nr. 216, datë 22.12.2014 **nuk ekziston më**. Gjithashtu, me shkresën nr. 144 prot., datë 15.01.2015 të Komisionit të Ristrukturimit është propozuar ndërrprerja e marrëdhënieve të punës dhe me vendimin nr. 10 (nr. 169prot.) datë 16.01.2015 është vendosur lirimi nga detyra dhe ndërprerja e marrëdhënieve të punës.

12. ***** – nëpunës civil i nivelit ekzekutiv me detyrë “*Specialist për Politikat Sociale në Sektorin e Marrëdhënieve për Bashkitë edhe Komunat në Drejtorinë e Zhvillimit Rajonal*” (kategoria IV-a). Ka filluar punë pranë Këshillit të Qarkut Tiranë me urdhrin e titullarit nr. 3, datë 04.01.2008 në pozicionin “*Specialist për Politikat Sociale*” (kategoria IV-a). Aktin e Deklarimit të statusit të punësimit si nëpunës civil me nr. 679/3, datë 13.06.2014 e ka në të njëjtin pozicion.Me njoftimin e Sekretarit të Përgjithshëm dhe Njesisë së Menaxhimit të Burimeve Njerëzore nr. 66 prot., datë 05.01.2015, është njoftuar që vendi i punës është suprimuar në bazë të Vendimitnr. 216, datë 22.12.2014 “*Për miratimin e strukturës organike së Administratës së Këshillit të Qarkut Tiranë*”.Ky pozicion me strukturën e re të miratuar me Vendimin nr. 216, datë 22.12.2014 **nuk ekziston më**. Gjithashtu, me shkresën nr. 142 prot., datë 15.01.2015 të Komisionit të Ristrukturimit është propozuar ndërrprerja e marrëdhënieve të punës dhe me vendimin nr. 9 (nr. 168 prot.) datë 16.01.2015 është vendosur lirimi nga detyra dhe ndërprerja e marrëdhënieve të punës.

13. ***** – nëpunës civil i nivelit ekzekutiv me detyrë “*Specialist për teknologjinë dhe informacionin në Sektorin e Shërbimeve dhe Personelit nëDrejtorinë e Shërbimeve, Çështjeve Ligjore dhe Personelit*” (kategoria IV-a). Ka filluar punë pranë Këshillit të Qarkut Tiranë me urdhrin e titullarit nr. 30, datë 12.10.2009 në pozicionin “*Specialist për Teknologjinë dhe Informacionin*”. Aktin e Deklarimit të statusit të punësimit si nëpunës civil me nr. 386/3, datë 20.03.2014 e ka në të njëjtin pozicion. Me njoftimin e Sekretarit të Përgjithshëm dhe Njesisë së Menaxhimit të Burimeve Njerëzore nr. 67 prot., datë 05.01.2015, është njoftuar që vendi i punës është suprimuar në bazë të Vendimitnr. 216, datë 22.12.2014 “*Për miratimin e strukturës organike së Administratës së Këshillit të Qarkut Tiranë*”.Ky pozicion me strukturën e re të miratuar me Vendimin nr. 216, datë 22.12.2014 **nuk ekziston më**. Gjithashtu, me shkresën nr. 145 prot., datë 15.01.2015 të Komisionit të Ristrukturimit është propozuar ndërrprerja e marrëdhënieve të punës dhe me

vendimin nr. 13 (nr.172prot.) datë 16.01.2015 është vendosur lirimi nga detyra dhe ndërprerja e marrëdhënieve të punës.

14. ***** – nëpunës civil i nivelit ekzekutiv me detyrë “*Specialist për Emergjencat dhe Statusin e Dëshmorit në Sektorin e Shërbimeve dhe Personelit në Drejtorinë e Shërbimeve, Çështjeve Ligjore dhe Personelit*” (kategoria IV-a). Ka filluar punë pranë Këshillit të Qarkut Tiranë me urdhrin e titullarit nr. 16, datë 08.05.2012 në pozicionin “*Specialist për Emergjencat dhe Statusin e Dëshmorit në Drejtorinë e Shërbimeve, Çështjeve Ligjore dhe Personelit*”. Aktin e Deklarimit të statusit të punësimit si nëpunës civil në periudhë prove me nr. 682/3, datë 13.06.2014 e ka në të njëjtin pozicion. Me njoftimin e Sekretarit të Përgjithshëm dhe Njësisë së Menaxhimit të Burimeve Njerëzore nr. 68 prot., datë 05.01.2015, është njoftuar që vendi i punës është suprimuar në bazë të Vendimit nr. 216, datë 22.12.2014 “*Për miratimin e strukturës organike së Administratës së Këshillit të Qarkut Tiranë*”. Ky pozicion me strukturën e re të miratuar me Vendim nr. 216, datë 22.12.2014 **nuk ekziston më**. Gjithashtu, me shkresën nr. 146 prot., datë 15.01.2015 të Komisionit të Ristrukturimit është propozuar ndërprerja e marrëdhënieve të punës dhe me vendimin nr. 14 (nr.173prot.) datë 16.01.2015 është vendosur lirimi nga detyra dhe ndërprerja e marrëdhënieve të punës. Punonjësi ***** duke mos qenë dakord me vendimin e mësipërm ka depozituar pranë Gjykatës Administrative të Shkallës së Parë një kërkesë-padi duke kërkuar shfuqizimin e vendimit nr. nr. 14, datë 16.01.2015 të Këshillit të Qarkut Tiranë dhe rikthimin e tij në vendin e mëparshëm të punës si dhe detyrimin për pagimin e pagës mujore deri në ekzekutimin e vendimit gjyqësor. Statusi i këtij procesi gjyqësor është në fazën e gjyqimit.
15. ***** – nëpunës civil i nivelit ekzekutiv me detyrë *Specialiste e transportit në Drejtorinë e Planifikimit Urban, Infrastrukturës dhe Transportit*” (kategoria IV-a). Ka filluar punë pranë Këshillit të Qarkut Tiranë në pozicionin *Specialist për Liçensat dhe Rrugët Rurale në Departamentin e Burimeve Njerëzore, Financës dhe Shërbimeve në Këshillin e Qarkut Tiranë* me urdhrin e brendshëm nr. 56 (nr. 2448 prot.) datë 13.06.2008 dhe bashkëlidhur kontrata e punës me nr. 2448/1 datë 15.06.2008 (emërim i përkohshëm deri në përfundim të procedurave të konkurrimit). Marrëdhëniet financiare kanë filluar në datë 15.06.2008. Më pas punonjësja ***** është emëruar me procedurë rekrutimi sipas shkresës me nr. 402/2 prot., datë 09.02.2009 në pozicionin *Specialist për Liçensat dhe Rrugët Rurale në Departamentin e Burimeve Njerëzore, Financës dhe Shërbimeve në Këshillin e Qarkut Tiranë* është konfirmuar në po të njëjtin pozicion pune me Vendimin nr. 5 (nr. 656 prot.) datë 23.02.2010. Me Aktin nr. 682/5 prot., datë 11.08.2014 “*Relacion mbi verifikimin e procedurës së rekrutimit dhe deklarimit të punësimit aktual të ******”, deklarohet nëpunës që brenda afatit ligjor duhet të plotësojë kriterin e përputhjes së arsimimit me pozicionin e punës. Me njoftimin

e Sekretarit të Përgjithshëm dhe Njesisë së Menaxhimit të Burimeve Njerëzore nr. 59 prot., datë 05.01.2015, është njoftuar për faktin se vendi i punës është suprimuar në bazë të Vendimit nr. 216, datë 22.12.2014 “*Për miratimin e strukturës organike të Administratës së Këshillit të Qarkut Tiranë*”. Ky pozicion me strukturën e re të miratuar me Vendimin nr. 216, datë 22.12.2014 **nuk ekziston më**. Gjithashtu, me shkresën nr. 139 prot., datë 15.01.2015 të Komisionit të Ristrukturimit është propozuar ndërprerja e marrëdhënieve të punës dhe me vendimin nr. 6, datë 16.01.2015 të Këshillit të Qarkut Tiranë është vendosur lirimi nga detyra dhe ndërprerja e marrëdhënieve të punës. Punonjësja ***** duke mos qenë dakord me vendimin e mësipërm ka depozituar pranë Gjykatës Administrative të Shkallës së Parë një kërkesë-padi duke kërkuar shfuqizimin e vendimit nr. 6, datë 16.01.2015 të Këshillit të Qarkut Tiranë dhe rikthimin e saj në vendin e mëparshëm të punës si dhe detyrimin për pagimin e pagës mujore deri në ekzekutimin e vendimit gjyqësor. Statusi i këtij procesi gjyqësor është në fazën e gjyqimit.

Konkluzion: ► Duke qenë se situata e punonjësës ***** ishte edhe në objektin e inspektimit, Komisioneri për Mbikëqyrjen e Shërbimit Civil konstatoi si më poshtë:

Në lidhje me rastin e punonjësës ***** vlerësohet se për verifikimin dhe deklarin e statusit të punësimit, institucioni ka përdorur bazë ligjore të gabuar, kur i referohet nenit 6/1 të VKM nr. 532 dt. 06.08.2014 “*Për disa shtesa dhe ndryshime Vendimit nr. 116, datë 05.03.2014 të Këshillit të Ministrave “Për statusin e nëpunësve dhe punonjësve aktualë që përfitojnë statusin e nëpunësit civil sipas ligjit nr. 152/2013 “Për nëpunësin civil” i ndryshuar. Vendimi i njesisë përgjegjëse për deklarin e statusit të punësimit (Aktin nr. 682/5 prot., datë 11.08.2014 “Relacion mbi verifikimin e procedurës së rekrutimit dhe deklarin të punësimit aktual të *****”) me anë të së cilës, kësaj nëpunëseje, i lihet afat për plotësimin e kriterit arsimor të pozicionit të punës, kjo vjen në kundërshtim me dispozitat ligjore.*

Punonjësja ***** ka përfunduar Universitetin e Tiranës, Dega Gjuhë-Letërsi, dhe ka kryer studime pasuniversitare në Shkenca Administrative. Është rekrutuar në vitin 2008 duke respektuar gjithë kërkesat e legjislacionit të kohës (*është publikuar pozicioni i lirëme shkresën nr. 5535 prot., datë 18.12.2008 në gazetën Shekulli dhe RD,*); në kriteret e veçanta të pozicionit të punës nuk ishte specifikuar ndonjëkriter i veçantë arsimor, por ishte lënë i hapur – *Arsim i lartë*. Duke qenë se edhe aktualisht jemi para faktit që përshkrimet e pozicioneve të punës nuk ekzistojnë por, institucioni funksionon në bazë të rregullores së brendshme të miratuar me Vendimin nr. 218, datë 22.12.2014 konkludojmë se në të nuk ka kritere specifike për asnjë pozicion pune. Në këto kushtevlerësohet që vendimi i njesisë përgjegjëse për deklarin e statusit të punësimit (akti nr. 682/5 prot., datë 11.08.2014 “*Relacion mbi verifikimin e procedurës së rekrutimit dhe deklarin të punësimit aktual të ******”) me anë të së cilës, ***** i lihet afati ligjor për plotësimin e kriterit të përputhjes së arsimit me pozicionin e punës, nuk është i drejtë.

Punonjëses ***** duhej ti ishte njohur statusi i punësimit “*nëpunës civil*” në pozicionin *Specialist Transporti në Sektorin e Infrastrukturës dhe Transportit në Drejtorinë e Planifikimit Urban, Infrastrukturës dhe Transportit* dhe më pas, të bëhej vlerësimi nëse i plotëson ose jo kërkesat e veçanta për pozicionet e punës të mbetura ose të krijuara pas ristrukturimit. Për rregullimin e ligjshmërisë, Komisioneri për Mbikëqyrjen e Shërbimit Civil rekomandon se duhet të bëhet revokimi i aktit të mëparshëm (akti nr. 682/5 prot., datë 11.08.2014 “*Relacion mbi verifikimin e procedurës së rekrutimit dhe deklarimit të punësimit aktual të ******”), dhe të fillohet edhe njeherëprocedura e deklarimit të statusit të nëpunësit civil për këtë punonjëse. Pas kësaj, të bëhet vlerësimi, nëse plotësohen ose jo prej saj, kërkesatë pozicionit të punës, të mbeturaose të krijuara pas ristrukturimit të Këshillit tëQarkut Tiranë.

► **Analiza e disa aspekteve, që lidhen me kuptimin dhe zbatimin e dispozitave të ligjit nr. 152/2013, “Për nëpunësin civil”, i ndryshuar, Vendimin nr.171, datë 26.03.2014, “Për transferimin e përhershëm dhe të përkohshëm të nëpunësve civilë, pezullimin dhe lirimimin nga shërbimi civil”, të Këshillit të Ministrave, Kreu III, “Transferimi për shkak të mbylljes dhe ristrukturimit të institucionit” dhe Vendimin nr.142, datë 12.03.2014 “Për përshkrimin dhe klasifikimin e pozicioneve të punës në institucionet e administratës shtetërore dhe institucionet e pavarura” të Këshillit të Ministrave të konstatuara gjatë inspektimit të përgjithshëm në Këshillin e Qarkut Tiranë**

Në kuadër të detyrës së caktuar, për verifikimin e mënyrës së zbatimit të ligjit nr. 152/2013 “*Për nëpunësin civil*”, i ndryshuar, Komisioneri për Mbikëqyrjen e Shërbimit Civilinspektoi gjithë procedurën e krijimit, funksionimit dhe konkluzionet e Komisionit të Ristrukturimit, prej nga rezultoi se: me urdhrin nr.2, datë 05.01.2015 të titullarit të institucionitëshhtë ngritur Komisioni i Ristrukturimit, bazuar në nenin 50 pika 3 të ligjit nr. 152/2013 “*Për nëpunësin civil*” i ndryshuar.

Në këtë akt konstatohet se nga ana e institucionit ka një kuptim të drejtë të nenit 50 pika 3 të ligjit nr. 152/2013 “*Për nëpunësin civil*” i ndryshuar dhe Vendimit nr.171, datë 26.03.2014 datë26.03.2014“*Për transferimin e përhershëm dhe të përkohshëm të nëpunësve civilë, pezullimin dhe lirimimin nga shërbimi civil*” të Këshillit të Ministrave, në lidhje me Komisionin e Ristrukturimit dhe mënyrën e ndërtimit të tij. Në përbërjen e tij është përfshirë vetë Sekretari i Përgjithshëm si nëpunësi më i lartë në shërbimin civil dhe njësia e menaxhimit të burimeve njerëzore, e cila përfaqësohet nga specialistja, por që me strukturën e vjetër kryente detyrën e Drejtores së Drejtorisë së Shërbimeve, Çështjeve Ligjore dhe Personelit.

Procedura e ndjekur nga Komisioni i Ristrukturimit është konform ligjit, pasi në tërësi, janë respektuar të gjitha kërkesat e nenit 50 të ligjit nr. 152/2013 “*Për nëpunësin civil*”, i ndryshuar ashtu dhe të VKM nr. 171, datë 26.03.2014 “*Për transferimin e përhershëm dhe të përkohshëm të nëpunësve civilë, pezullimin dhe lirimimin nga shërbimi civil*”.Vërehet që në gjithë rastet e trajtuara prej tij dhe propozimet e bëra, si për lirimimin nga shërbimi civil ashtu dhe për propozimet për rrimërim pas ristrukturimit, janë bërë në përputhje të plotë me kërkesat e ligjit dhe akteve nënligjore, si dhe me cilësitë personale dhe eksperiencën e secilit punonjës.Gjithashtu ështëmbajtur korrespondencë me Departamentin e Administratës Publike(shkresa me nr. 3731/2 prot.,datë21.05.2015 “Kthim përgjigje tuajës nr. 1508 prot., datë20.11.2014”), duke respektuar

pikën 6 të nenit 50 të ligjit nr. 152/2013 “Për nëpunësin civil”, i ndryshuar dhe me institucionet e tjera në lidhje me transferimin e mundshëm të nëpunësve që vendi ju është suprimuar (sic është rasti i punonjësit ***** i cili është transferuar në pozicionin *Specialist* në komunën Farkë dhe punonjësja *****), që është rimarë në punë si sekretare e titullarit), të dyja këto raste të vërtetuara me deklaratat personale.

Aktet e emërimit janë individuale dhe rimeërimet e nëpunësve civilë në pozicione të një kategorie të barabartë ose më të ulët, janë bërë duke marrë paraprakisht deklarinim me shkrim të nëpunësit nëse jep pëlqimin ose jo për detyrën e re, siç përcaktohet në pikën 20, Kreu III, “Transferimi për shkak të mbylljes dhe ristrukturimit të institucionit” të VKM nr.171, datë 26.03.2014, “Për transferimin e përhershëm dhe të përkohshëm të nëpunësve civilë, pezullimin dhe lirin nga shërbimi civil” .

Proceset e punës në këtë institucion disiplinohen nëpërmjet Rregullores së Brendshme të institucionit, të miratuar me Vendimin nr. 218, datë 22.12.2014, në të cilën janë shprehur mjaft qartë detyrat për secilin pozicion pune. Por konstatohet se mungojnë kriteret specifike mbi të cilat duhet të kryhen pranimet në shërbimin civil. Kjo mangësi do të rregullohej nëse do të ishin përshtatimet individuale të punës.

Gjithësesi, këto parregullsi nuk cënojnë në tërësi procesin e ristrukturimit. Ky proces ka qenë i kushtëzuar nga ligji nr.160/2014 “Për buxhetin e vitit 2015” dhe në këtë kontekst është dashur të veprohet me shpejtësi për të zbatuar procedurën e ristrukturimit sipas kërkesave ligjore, por dhe respektuar të drejtat e nëpunësve civilë të prekur nga procesi (janë ndërprerë në tërësi 15 marrëdhënie pune, nga të cilët 2 janë sistemuar). Fillimi dhe përfundimi i procesit në një kohë të shpejtë është dhe shkak i lejimit të disa parregullsive të karakterit subjektiv, si pasojë e kuptimit të gabuar të legjislacionit për shërbimin civil. Ky ligj ka një zhvillim dinamik dhe implementimi i tij do të kërkojë kohë dhe trajnime të vazhdueshme të cilat do të jenë të domosdoshme për nëpunësit e Këshillit të Qarkut Tiranë.

- **Organizimi i Dosjes dhe Regjistrimit të Personelit.**

Nga këqyrja e akteve të administruara në dosjen e personelit, si një dokument i krijuar në zbatim të nenit 17 të ligjit nr. 152/2013, “Për nëpunësin civil”, rezulton se janë të administruara dokumentat e identifikimit (fotokopje e pasaportës); dokumenta që tregojnë për gjendjen civile (çertifikata e gjendjes familjare); dokumenta që vërtetojnë edukimin arsimor (diploma e shkollës së lartë); dokumenta që vërtetojnë momentin e fillimit të marrëdhënies së punës (akti i emërimit); akte që tregojnë për nivelin e kualifikimit (çertifikata kualifikimi), etj.

Administrimin e këtyre akteve në dosjen individuale të nëpunësit civil, e kërkon në mënyrë të shprehur, pika 2 e Kreut I, të Vendimit nr. 117, datë 05.03.2014, të Këshillit të Ministrave, “Për përmbajtjen, procedurën dhe administrimin e dosjeve të personelit e të regjistrimit qendror të personelit” si dhe lidhja 1 dhe 2, pjesë të këtij vendimi.

Konkluzion: Komisioneri për Mbikëqyrjen e Shërbimit Civil vlerëson se, dosjet e personelit janë të sistemuara dhe ruhen në kushte të përshtatshme, në ambientet e institucionit dhe administrohen nga Specialisti i Burimeve Njerëzore, që është nëpunës përgjegjës për administrimin e burimeve njerëzore për institucionin, por në të gjitha dosjet mungonin raportit

shëndetësor dhe vërtetimi i gjëndjes gjyqësore të cilat lihen detyrë për tu plotësuar menjëherë, brenda afatit që do të lihet në vendimin për miratimin e këtij raporti.

Komisioneri për Mbikëqyrjen e Shërbimit Civil nuk konstatoi raste të lëvizjeve paralele, procedura të ngritjes në detyrë, raste të ecurive disiplinore, raste të transferimeve të përkohshme, apo pezullimit nga shërbimi civil.

KOMISIONERI

Pranvera STRAKOSHA